



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE



Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi Nr: 8/2015

VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR POLICIMIN NË BASHKËSI (2012-2016)



(2015)

Aprovuar
Fitim Shishani
Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së

SHKURTESAT

DPBP	Drejtoria për Policim në Bashkësi dhe Parandalim
DPSÇL	Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
DRP	Drejtoria Rajonale Policore
DRPK	Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare
DI	Departamenti i Inspektiveve
DIA	Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës
DMO	Drejtoria e Menaxhimit të Objekteve
DT	Drejtoria e Trajnimeve
DTI	Drejtoria e Teknologjisë Informative
DTK	Departamenti i Trashëgimisë Kulturore
EVSN	Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi
FIQ	Forumi për Iniciativa Qytetare
FRP	Forumi Rinor i Prishtinës
IAMK	Instituti Arkeologjik i Muzeut të Kosovës
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KEC	Kosovo Education Center
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshilli Lokal për Siguri Publike
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
OJQ	Organizata jo-qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
UNDP	United Nations Development Program
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	(4-6)
2. HYRJE	(7-9)
3. PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE	(10-29)
3.1. Vlerësimi i veprimeve të PK-së në vendosjen e kushteve për përmirësimin e cilësisë së shërbimit policor përmes të policimit në bashkësi.	
3.2. Vlerësimi i veprimeve të PK-së në avancimin e partneritetit me bashkësinë, si parakusht për zhvillimin e policimit efektiv, demokratik, të nevojshëm për të rritur sigurinë, qetësinë, lirinë e lëvizjes dhe cilësinë e përgjithshme të jetës për të gjithë qytetarët.	
3.3. Vlerësimi i veprimeve të PK-së që në partneritet me publikun të përfshihet në proceset e zgjedhjes së problemeve që identifikojnë, analizojnë dhe përgjigjen ndaj shqetësimeve të publikut.	
3.4. Identifikimi i problemeve në realizimin e Planit të Veprimit për Policim në Bashkësi.	
4. PËRFUNDIMET	(30-31)
5. REKOMANDIMET	(32-33)
6. PLANI I VEPRIMIT NË PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE	(34-35)

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1. Në bazë të nenit 24, paragrafi 2 të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK-ja ka zhvilluar inspektim të rregullt në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Divizionin e Sigurisë Publike dhe Departamentin e Kufirit. Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të vlerësuar zbatimin e Planit të Veprimit në jetësimin e Strategjisë për Policimin në Bashkësi. Inspektorët kanë trajtuar nivelin e zbatimit të rreth 83% të detyrave të Planit të Veprimit, në të cilat janë përfshirë akterët e paraparë (60 nga 72 detyra të Planit).

1.2. Inspektimit në këtë fushë i ka parapri hartimi i Programit inspektues duke përfshirë metodologjinë e punës. Programi inspektues ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren me datë 15 shtator 2015, ndërsa data 27 tetor 2015 është planifikuar të jetë datë e përfundimit të punës në terren. Janë trajtuar aktivitetet e ndërmarra policore në zbatimin e Strategjisë, duke filluar nga maji i vitit 2012 kur ka filluar së realizuari ky projekt strategjik, deri në pjesën e parë të vitit 2015. Janë disa detyra të ndara me këtë Plan, që priten të trajtohen dhe përbushen në vazhdimësi, meqë periudha e realizimit të këtyre detyrave përfshin edhe vitin 2016.

1.3. Të gjeturat lidhur me arritjen e synimit të parë strategjik (*Policia në të gjitha nivelet e udhëheqjes vendos kushte për përmirësimin e cilësisë së shërbimit policor përmes policimit në komunitet*) tregojnë se është arritur përbushje e konsiderueshme e detyrave të ndara me Plan Veprimi. Nga njëzetë (20) detyra të parapara me Plan Veprimi për arritjen e këtij synimi strategjik, 18 prej tyre janë përbushur plotësisht, një (1) nuk është trajtuar fare dhe një (1) tjetër është trajtuar jo kënaqshëm.

1.4. Detyra të përbushura janë konsideruar ato që lidhen me fushat si në vazhdim: emërimi i akterëve në realizimin dhe monitorimin e Planit dhe Strategjisë, nxjerrja e rregullativës ligjore/organizative, nxjerrja e programeve trajnuese, përfshirë përgatitjen e trajnerëve të policimit në bashkësi dhe përgatitjen e personelit me trajnimet e nevojshme, zhvillimi dhe avancimi i programit informativ për një rrjedhë të informatave, promovimi i aktiviteteve rreth zhvillimit dhe avancimit të partneritetit me komunitetin. Lidhur me detyrën për nxjerrjen e Doracakut për policimin në bashkësi nuk është identifikuar asnjë aktivitet, derisa detyrë e trajtuar jo kënaqshëm është konsideruar ndarja e detyrave dhe përgjegjësive për Koordinatorin për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit nga Strategjia për Policimin në Bashkësi dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim.

1.5. Të gjeturat lidhur me arritjen e synimit të II-të strategjik (*Policia angazhohet në avancimin e partneritetit me bashkësinë si parakusht për zhvillimin e policimit efektiv, demokratik, të nevojshëm për të ngritur sigurinë, qetësinë, lirinë e lëvizjes dhe cilësinë e përgjithshme të jetës për të gjithë qytetarët*) tregojnë se në këtë periudhë strategjike kemi një aktivitet të kënaqshëm në identifikimin e partnerëve vendor e ndërkombëtar në mbështetje të jetësimin të Strategjisë. Numri i forumeve të sigurisë, takimeve me partnerë, numri i takimeve me qytetarë në promovimin e konceptit të policimit në bashkësi, numri i projekteve në ngritjen e sigurisë së komunitetit, numri i vullnetarëve dhe grupeve të përfshira në iniciativa për të ndihmuar PK-në në situata jo emergjente, numri i ligjëratave mbi dukuritë negative, numri i informatave mbi mekanizmat e ankesave, numri i informatave mbi statusin e rasteve të raportuara, numri i vizitave lidhur me portën e hapur, numri i raportimeve të forumeve të sigurisë, numri i takimeve me komunitetin në identifikimin e zyrtarëve policorë dhe ndarjen e roleve dhe përgjegjësive të tyre, ka shënuar ngritje nga viti në vit.

1.6. Tek stacionet dhe DRP-të ka munguar qasja analitike e prezantimit të partnerëve. Nuk është themeluar Grupi për ndarjen e mirënjohjeve, me gjithë që në një rast ndarjen e mirënjohjeve e kanë bërë Koordinatori me Grupin Punues. Është vlerësuar i nevojshëm hapi në përmirësimin e raportimit në mes tri niveleve (Koordinatori- Koordinatori Rajonal i Policimit në Bashkësi- Udhëheqësi i stacionit), ngase vërehen mos përputhje në mes të të dhënave të prezantuara mbi përmbushjen e detyrave të Planit të Veprimit (përfshirë edhe elementet përmbajtjesorë të raportimeve). Duhet punuar edhe më tutje në nxjerrjen e të dhënave mbi 'numrin e prezantimit të mundësive' tek qytetarët mbi komunikimin reciprok e të sigurt, si dhe të numrit të stacioneve të vizituara nga qytetarët. DRP e Mitrovicë Veriore ka ngecur në përmbushjen e një numri detyrash, me gjithë faktin se stacionet policore edhe pse janë inkorporuar vonë në kuadër të Drejtorisë së re policore, ato më parë kanë funksionuar në kuadër të DRP-së së Mitrovicës Jugore. Ka vazhduar organizimi i takimeve të rregullta të këshillave ekzekutive të KLSP-ve. Bazat fizike të të dhënave mbi KLSP-të konsiderohen të krijuara, por adresuar tek PK-ja nevojën për analizimin e krijimit të bazës së integruar elektronike të të dhënave mbi KLSP-të. Në përjashtim të Stacionit policor të Zveçanit që nuk ka përmbyllur plotësisht aktivitetin në krijimin e dosjeve sektoriale, të gjitha stacionet tjera kanë përmbyllur me sukses një proces të tillë.

1.7. Të gjeturat lidhur me arritjen e synimit të III-të strategjik (*Policia në partneritet me publikun përfshihet në proceset e zgjidhjes së problemit që identifikojnë, analizojnë dhe përgjigjen ndaj shqetësimeve të komunitetit*) tregojnë se është shënuar ngritje e numrit të OJQ-ve dhe forumeve të sigurisë në zgjidhjen e problemeve të komunitetit, numrit të raportimeve policore tek njësitë përkatëse mbi shqetësimet e qytetarëve, numrit të analizave policore mbi problemet e mundshme të adresuara të qytetarëve, numri i prioritetëve në adresimin e problemeve të qytetarëve, numri i patrullimeve nga sektorë të Departamentit të Kufirit dhe numri i procedimeve nga Departamenti i Kufirit lidhur me rastet që lidhen me veprat penale 'kalimi ilegal i kufirit' dhe 'kontrabandimi me migrant'.

1.8. Shënohet rënie e numrit të qytetarëve të përfshirë në zgjidhjen e problemeve, numrit të rasteve të zgjidhura si rezultat i bashkëpunimit me qytetarë dhe numrit të takimeve ndërkufitare të Departamentit të Kufirit. Lidhur me identifikimin e zyrtarëve përgjegjës për avancim partneriteti me komunitetin, del se me gjithë prezantimin e shënimeve mbi caktimin e zyrtarëve përgjegjës, raportet nuk sqarojnë se cilat nivele janë përfshirë, kur kemi parasysh se në shifrën prej 670 zyrtarësh, është përfshirë niveli rajonal e lokal. Detyra e dhënë përcakton se këtu përfshihen të gjitha nivelet e organizimit, përfshirë edhe zyrtarët e nivelit qendror.

1.9. Realizimi i Planit dhe Strategjisë është sfiduar nga një numër faktorësh objektivë dhe subjektivë, që kanë shkaktuar vështirësi dhe pengesa drejt realizimit të synimeve strategjike. Faktorët e tillë kanë qenë të natyrës: *organizative* (mungesa e personelit të nevojshëm për punë sektoriale, angazhimi i kapaciteteve të burimeve ekzistuese në aktivitete jo policore, transferet e policëve në sektorë, moshja e shtyrë e një numri zyrtarësh të angazhuar në sektorë, mungesa e trajnimeve të nevojshme që lidhet me konceptin e policimit në bashkësi); *teknike-logjistike* (mungesa e pajisjeve teknike dhe automjeteve, mungesa e hapësirave për punë në objekte policore dhe për punë në terren) dhe *të partneritetit* (mungesa e gatishmërisë së qytetarëve për të ndërtuar dhe zhvilluar partneritet reciprok, njohuritë jo të duhura mbi konceptin e policimit në bashkësi dhe mos gatishmëria e qytetarëve për të kontribuar në forume të sigurisë për shkak të mos pagesës së angazhimeve të tyre).

1.10.Mbi të gjeturat e paraqitura në këtë Raport, më 18.12.2015, IPK-ja ka realizuar takim përmbyllës me menaxhmentin e PK-së, fushëveprimi i të cilit lidhet me fushën e inspektuar. Janë diskutuar detajet e raportit dhe më pas palët janë pajtuar me të gjeturat e inspektimit.

2. HYRJE

2.1. 'Policimi në Bashkësi' si një koncept demokratik që dallon nga ai tradicional, nuk sheh Policinë si aktor të vetëm në çështjet e sigurisë. Sipas këtij koncepti të ri, kontribut dhe përgjegjësi në ngritjen e sigurisë kanë edhe qytetarët dhe institucionet tjera, përmes bashkëpunimit me policinë. Sipas këtij koncepti, në drejtim të ngritjes së nivelit të sigurisë në bashkësi, qytetarët shtyhen apo motivohen që të jenë më aktiv në raportimin e dukurive negative dhe veprave kriminale. Si një koncept i avancuar që ka si shtyllë partneritetin me komunitetin, në drejtim të zbatimit të saj praktik, kërkon një transformim organizativ, ndërtim të ngushtë partneriteti dhe qasje më ndryshe në adresimin e bregave të qytetarëve.

2.2. Për të kaluar në këtë koncept të policimit, PK-ja ka studiuar punën policore që nga themelimi i saj si agjenci e sigurisë dhe duke marrë për bazë rezultatet e punës dhe përvojat e shteteve demokratike, pas një pune të palodhshme me partnerët ndërkombëtarë, ka nxjerrë dhe prezantuar një strategji afatgjate të Policimit në Bashkësi. Kjo Strategji, partneritetin me qytetarë e sheh si një çelës suksesi në drejtim të ngritjes së nivelit të sigurisë. Projektit i ka paraprirë ndërmarrja e një numri hapash, si: nxjerrja dhe ndryshimi i disa akteve nënligjore, organizimi i punës, ndryshimet në edukim dhe ngritje profesionale, ngritja e kulturës së komunikimit me qytetarë, ndryshimet në sjelljen dhe etikën policore, etj.

2.3. Duke lëvizur me këtë koncept nga qasja reaktive e zgjedhjes së problemeve të qytetarëve, në atë pro-aktive (parandaluese), përafrimi i policisë me qytetarët u siguron këtyre të fundit qasje aktive në raportimin e dukurive dhe krimeve brenda territorit ku veprojnë por edhe të bregave të tyre mbi probleme të mundshme. Synohet që duke u mbështetur ky koncept, qytetarët nuk do të shohin forcën policore si instrument dhune, por si palë partnere në ngritjen e shkallës së sigurisë. Për zbatimin e Strategjisë për Policimin në Bashkësi, PK-ja ka nxjerrë edhe Planin e Veprimit, i cili ka paraprirë detyrat për aktorët e përfshirë dhe afatet kohore të përbushjes së detyrave konkrete.

2.4. IPK-ja ka autorizuar një inspektim për të vlerësuar zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Policimin në Bashkësi. Inspektimi është ndërmarrë pasi janë siguruar kapacitetet e mjaftueshme për të vlerësuar kryerjen e detyrave në këtë fushë, me qëllim:

- që të vlerësohen veprimet e ndërmarrja policore në ngritjen e kapaciteteve të nevojshme, avancimin e partneritetit dhe përfshirjen policore në adresimin e shqetësimeve të qytetarëve,
- të jepet një mendim objektiv mbi shkallën e përbushjes së detyrave policore që dalin nga Plani Veprues Strategjik,
- që të identifikohen pikat e dobëta të zhvillimit strategjik që ngadalësojnë apo sfidojnë zbatimin e Planit Veprues,
- që të jepen rekomandime mbi mënyrën se si nivelet e organizimit policor mund të ndikojnë në zbatimin më efektiv të detyrave të parapara me Planin e Veprimit.

2.5. Objekt i këtij inspektimi ishte vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Policimin në Bashkësi (2012-2016), kurse subjekt i inspektimit ishin të gjitha nivelet e organizimit policor, përfshirë nivelin qendror, rajonal dhe atë lokal.

2.6. Me rastin e planifikimit të aktiviteteve në funksionalizimin e këtij inspektimit, DI-ja ka vënë para vetes këto katër (4) objektiva:

- të vlerësohen veprimet e PK-së në vendosjen e kushteve për përmirësimin e cilësisë së shërbimit policor përmes të policimit në bashkësi;
- të vlerësohen veprimet e PK-së në avancimin e partneritetit me bashkësinë, si parakusht për zhvillimin e policimit efektiv, demokratik, të nevojshëm për të rritur sigurinë, qetësinë, lirinë e lëvizjes dhe cilësinë e përgjithshme të jetës për të gjithë qytetarët;
- të vlerësohen veprimet e PK-së që në partneritet me publikun të përfshihet në proceset e zgjedhjes së problemeve që identifikojnë, analizojnë dhe përgjigjen ndaj shqetësimeve të publikut; dhe
- të identifikohen problemet në realizimin e Planit të Veprimit për Policimin në Bashkësi.

2.7. Strategjia për Policimin në Bashkësi ka filluar të zbatohet bazuar në një Plan Veprimi, i cili parasheh hapat që duhet ndërmarrë, akterët e përfshirë në të, implikimet buxhetore në arritjen e objektivave dhe periudhën kohore të zbatimit. Me gjithë faktin, se planet janë duke u zhvilluar në vazhdimësi, rëndësia e organizimit të këtij inspektimi qëndron në gatishmërinë e agjencisë sonë për të vlerësuar hapat e ndërmarrë nga PK-ja deri në këtë fazë zhvillimi, me arsyen që të identifikohen pengesat e mundshme dhe të ofrohet mbështetje në jetësimin sa më të suksesshëm të Planit Strategjik. Veç tjerash, inspektimi në këtë fushë luan rol të rëndësishëm dhe do të kontribuojë në:

- vlerësimin mbi nivelin e përmbushjes së detyrave që dalin nga Plani i Veprimit,
- mbështetjen policore në identifikimin e vështirësive që sfidojnë zbatimin e Planit.

2.8. E autorizuar të kryejë këtë inspektim, IPK-ja ka angazhuar inspektorët, të cilët në vazhden e nxjerrjes së informacionit të duhur kanë siguruar:

- dokumente të shkruara (raporte pune, plane inspektimi, material inspektimi),
- të dhëna fizike që derivojnë nga plotësimi i formularëve standard të inspektimit,
- intervista nga punonjës policorë të nivelit drejtues dhe zbatues, si në vijim:
 - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë,
 - Drejtori i DPBP-së,
 - Koordinatori për Zbatim dhe Monitorim të Strategjisë për Policimin në Bashkësi,
 - Drejtori i DPSÇL-së,
 - Drejtori i DTI-së,
 - Drejtori i DT-së,
 - Udhëheqësi i ZIMP-it,
 - Drejtori i DIA-s,
 - Drejtori i Departamentit për Kufi,
 - Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore,
 - Koordinatorët Rajonalë të Policimit në Bashkësi,
 - Komandantët e stacioneve policore,
 - Koordinatorët e sektorëve të stacioneve policore,
 - Zyrtarët policorë të komunitetit.

2.9. Autorizimi për inspektim ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren më 15 shtator të vitit 2015. Sipas Programit të Punës Inspektuese, data 27 tetor 2015 është planifikuar

të jetë datë e përmbylljes së punës në terren. Periudha e vlerësuar në këtë raport inspektimi përfshin periudhën deri kur ka arritur së zbatuari Plani i Veprimit (2012-2016).

2.10. Inspektimi është përqendruar në këto fusha kryesore:

- Kapacitetet njerëzore, ligjore, profesionale e organizative,
- Zhvillimi dhe avancimi i partneritetit me bashkësinë,
- Pjesëmarrja në proceset e përbashkëta të zgjedhjes së problemeve të qytetarëve,
- Vështirësitë dhe pengesat e paraqitura në zbatimin e Planit të Veprimit.

2.11. Ky inspektim është bazuar në këtë kuadër ligjor:

- Ligjin për IPK-në (nr. 03/L-231),
- Udhëzimin Administrativ për Inspektime në PK (nr. 11/2011- MPB),
- Autorizimin zyrtar nr. 03-155 për kryerjen e inspektimit (i datës 11.09.2015).

2.12. Inspektorët policorë gjatë inspektimit kanë konsideruar se dokumentet në vijim do të jenë baza e duhur, në të cilën duhet mbështetur puna e tyre:

- Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Sigurinë në Bashkësi (2011-2016),
- Strategjia dhe Plani i Veprimit 2012-2016 (Policimi në Bashkësi),
- Raportet e Koordinatorit për Zbatimin dhe Monitorimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

3. PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE TË INSPEKTIMIT

3.1. Vlerësimi i veprimeve policore në vendosjen e kushteve për përmirësimin e cilësisë së shërbimit policor përmes të policimit në bashkësi

3.1.1. Lidhur me përmbushjen e detyrës 1.1.1 të Planit të Veprimit për Strategjinë e Policimit në Bashkësi (Emërimi i Koordinatorit dhe Grupit punues me përfaqësim nga të gjitha shtyllat për zbatim e monitorim të Strategjisë), inspektorët kanë siguruar dy vendime të lëshuara nga autoritete të ndryshme. Njëri vendim është lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë¹, me të cilin është caktuar Koordinatori për Implementimin dhe Monitorimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Policimin në Bashkësi dhe vendimi tjetër i lëshuar nga vetë Koordinatori², me të cilin dokument është themeluar Grupi punues për Implementimin e Planit të Veprimit, të dalë nga Strategjia. Përbërja e Grupit punues është e gjerë me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga të gjitha departamentet (shtyllat policore) dhe disa drejtori që janë konsideruar akterë me rëndësi në këtë proces (DPBP, DPSÇL).

3.1.2. Pika 1.1.2. e Planit ka përcaktuar që të bëhet 'caktimi i detyrave dhe përgjegjësive të Koordinatorit dhe Grupit punues'. Janë verifikuar informatat që përmban Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe nuk është vërejtur se në të janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit dhe të Grupit punues. Në Raportin Vjetor të Koordinatorit për vitin 2012³, mbi aktivitetet policore rreth jetësimit të Strategjisë, është përmendur se është nxjerrë dhe aprovuar një Rregullorë e Punës së Grupit punues për caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të Koordinatorit dhe anëtarëve të Grupit punues, mirëpo inspektorëve nuk iu është prezantuar një dokument i tillë.

3.1.3. Sipas pikës 1.1.3 të Planit të Veprimit është paraparë që nga autoritetet kompetente të bëhet 'rishikimi i strukturës organizative në mbështetje të Strategjisë'. Për të sqaruar përmbushjen e kësaj detyre, duhet potencuar se Strategjia ka filluar të jetësohet nga muaji maj i vitit 2012, muaj ky kur edhe PK-ja ka vënë në zbatim strukturën e re të organizimit të brendshëm. Përmbushja e kësaj pike të Planit është paraparë të arrihet deri në nëntor të vitit 2012, në mënyrë që struktura të aprovohet deri në muajin gusht të vitit 2013. IPK-ja nuk ka qenë e interesuar të sigurojë propozimet për strukturën e rishikuar, ngase që në fillim të zbatimit të Strategjisë, struktura organizative ka qenë e përgatitur dhe vetëm se ka filluar të fuqizohet në praktikë.

3.1.4. Pika 1.1.5. e Planit ka paraparë angazhimet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në 'plotësimin e nevojave të identifikuar për zbatimin e Strategjisë'. Është siguruar versioni final i strukturës së përgjithshme organizative⁴ të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, që është konsideruar nga menaxhmenti policor se ka pësuar ndryshime dhe pas rishikimit iu përgjigjet apo përshtatet nevojave të Strategjisë së Policimit në Bashkësi. Është siguruar edhe

¹ DPP, *Vendimi për caktimin e Koordinatorit për Implementim dhe Monitorim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit (2012-2016) për Policimin në Bashkësi*, DPPK-01/0414/2012, datë 25.04.2012.

² DPP, *Vendimi për themelimin e Grupit punues për Implementim të Planit të Veprimit të dalë nga Strategjia për Policimin në Bashkësi*, datë 25.05.12, Prishtinë.

³ Koordinatori për Implementimin dhe Monitorimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 'Policimi në Bashkësi' (2012-2016), *Raport informues*, 22.01.2013, Prishtinë.

⁴ DPP, *Struktura e përgjithshme organizative e PK-së*, 20.05.2012, Prishtinë.

versioni i strukturës organizative për kategoritë e stacioneve policore A, B dhe C⁵, që vlerësohet po ashtu se i përshtatet nevojave që dalin nga Strategjia.

3.1.5. Në vazhden e harmonizimit të PSO-ve dhe përshkrimit të vendeve të punës, DPSLÇ-ja dhe DPBP-ja janë ngarkuar sipas pikës 1.2.1 të Planit të Veprimit, me 'rishikimin dhe plotësimin e Parimit 5.12 (Veprimet e policisë në komunitet)'. Inspektorët kanë siguruar versionin e rishikuar/ plotësuar nga akterët e përfshirë në proces dhe dokumenti i tillë është aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Sipas këtij dokumenti të aprovuar në tetor të vitit 2012⁶, Parimi 5.12 përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e personelit të DPBP-së në nivel qendror dhe atë lokal; marrëdhëniet në Drejtori; komunikimin dhe mënyrat e fuqizimit të bashkëpunimit me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale; për të krijuar partneritet reciprok për siguri të përgjithshme të komunitetit.

3.1.6. Pika 1.2.2 dhe 1.2.4. e Planit të Veprimit përcakton 'rishikimin dhe plotësimin e PSO-ve të të gjitha niveleve policore'. Bazuar në informacionin e siguruar nga Departamenti i Operacioneve dhe ai i Kufirit, në vitin 2012 janë krijuar grupet punuese dhe kanë trajtuar një numër prej 23 PSO-ve që lidhen me policimin në bashkësi. Departamenti i Operacioneve ka bërë rishikimin dhe plotësimin e gjithsej nëntë (9) PSO-ve⁷, kurse Departamenti i Kufirit ka rishikuar dhe plotësuar gjithsej 14 PSO⁸. Sipas zyrtarëve të këtyre departamenteve, rishikimi i PSO-ve është një aktivitet në vazhdimësi, meqë ato trajtohen çdo vit, kur janë të nevojshme të kryhen ndërhyrjet eventuale.

3.1.7. Pika 1.2.3 dhe 1.2.5. e Planit ka përcaktuar ndërmarrjen e hapave në 'rishikimin, plotësimin dhe aprovimin e përshkrimeve të vendeve të punës'. Gjatë trajtimit të kësaj pike, ka ekzistuar një mëdyshje tek akterët e përfshirë se në fakt për çfarë përshkrimesh bëhet fjalë, për ato që dalin nga nxjerrja e PSO-së për veprimet e policisë në komunitet, apo ato që rrjedhin nga një proces të ndarë pune që lidhet me të gjitha përshkrimet e vendeve të punës, duke përfshirë të gjitha nivelet policore të PK-së. Sa i përket përshkrimeve të vendeve të punës si rezultat i nxjerrjes së PSO-së së re⁹, vërehet se kjo përmban përshkrimet dhe detyrat për tërë personelin e kyçur në nivelin policor që jetëson policimin në bashkësi. Nëse kësaj fushe i qasemi sipas qasjes së dytë, IPK-ja ka kontaktuar departamentin përkatës dhe ka trajtuar procesin nga nxjerrja e strukturës së organizimit të brendshëm, deri tek hapat e fundit në nxjerrjen e përshkrimeve të vendeve të punës. Bazuar në strukturën organizative është nxjerrë Lista e personelit të autorizuar dhe Lista e emërimit të pozitive për personelin e uniformuar, të aprovuar më 14.03.2014. Këto tre (3) hapa i kanë hapur rrugën edhe atij të fundit, nxjerrjes së përshkrimeve të vendeve të punës. Grupi punues i themeluar për këtë çështje ka përgatitur draft përshkrimet e vendeve të punës, që për momentin janë dërguar për aprovim te Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Nga propozimet e pranuar prej përfaqësuesve të çdo departamenti, Grupi punues ka bërë unifikimin e përshkrimit të detyrave për personelin policor. Veç kësaj, nga data 18.09.2015, Grupi punues i themeluar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka dërguar në MAP, draft-propozimet për përshkrimet e vendeve të punës për stafin civil në PK, së bashku me organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Me gjithë vonesat në

⁵ DPP, *Struktura organizative (stacionet policore A, B, C)*, 20.05.2012, Prishtinë.

⁶ DPP, *Parimi 5.12 (Drejtorja e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë)*, tetor 2012.

⁷ Departamenti i Operacioneve, *Raport informues mbi PSO-të e DPBP-së*, referencë 04/01-08/SPP/4083-2015, 08.12.2015, Prishtinë.

⁸ Departamenti i Kufirit, *Informatë lidhur me Strategjinë, Policimi në Bashkësi'*, 03.12.2015, Prishtinë.

⁹ DPP, *PSO për veprimtarinë policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit 2012-2016 dhe metodologjia e PK-së për policimin në komunitet (2010)*, ref. DDO-04/044/2013, 02.04.2013, Prishtinë.

nxjerrjen e këtyre përshkrimeve, aktivitet i paraparë ky që të përmbyllet deri në dhjetor të vitit 2012, gjendet në fazën e përmbylljes së këtij rrugëtimi, duke qartësuar edhe përshkrimet e vendeve të punës edhe për pjesën e personelit të uniformuar dhe atij administrativ.

3.1.8. Pika 1.2.7. e Planit të Veprimit ka paraparë që deri në shtator të vitit të parë të jetësimit të Strategjisë, të 'përgatitet dhe shpërndahet doracaku/manuali i policimit në bashkësi'. IPK-ja ka kontaktuar me zyrtarë të DPSÇL-së për të siguruar informacionin se çfarë ka ndërmarrë kjo Drejtori në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë për të nxjerrë një Doracak në shërbim të zyrtarëve policorë, por nuk i është prezantuar një dokument i tillë. Sipas zyrtarëve të Drejtorisë, nuk është arritur të sigurohen mjete për financimin e projektit në fjalë me gjithë premtimet e dhëna. IPK-ja është interesuar lidhur me atë se a është nxjerrë ndonjë draft dokument me përmbajtje nga fusha e policimit në bashkësi, por ka marrë përgjigje se nuk është punuar asgjë në këtë drejtim.

3.1.9. Pika 1.3.1. e Planit të Veprimit ngarkon me përgjegjësi Grupin për Zbatim dhe Monitorim dhe DTI-në në 'ndërtimin e Programit të veçantë në mbështetje të Strategjisë'. Inspektorët kanë siguruar një Raport informues nga DTI-ja¹⁰, sipas të cilit PK-ja gjatë vitit 2014 ka realizuar Sistemin Informativ të PK-së, të bazuar në metodologjinë e Policimit në Bashkësi dhe Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca. Në kuadër të Sistemit janë realizuar nën-modulet që ndërlidhen me Policinë në Bashkësi dhe atë të Udhëhequr nga Inteligjenca. Sipas Raportit në fjalë, këto përmbajnë të dhëna të mbledhura gjatë orarit të punës nga njësitë, zyrtarët patrullues, zyrtarët e policimit në bashkësi dhe atyre të inteligjencës. Sipas DTI-së, këto të dhëna të Sistemit mund të përdoren për raportime, statistika, analiza, hulumtime dhe hetime të ndryshme.

3.1.10. Pika 1.3.2. e Planit të Veprimit ka përcaktuar që të bëhet 'shtrirja e Sistemit të teknologjisë informative në të gjitha nivelet e organizatës së PK-së', aktivitet që ngarkon DTI-në dhe Grupin për Zbatim e Monitorim. Bazuar në Raportin informues të DTI-së, PK-ja ka një rrjetë të veçantë të teknologjisë informative të shtrirë në tërë territorin e vendit, përfshirë DPP-në, DRP-të, stacionet policore, nënstacionet dhe pikat kufitare. IPK-ja duke qenë e interesuar për funksionalizimin dhe shtrirjen e këtij Sistemi, është shërbyer me informacionin, sipas të cilit vlerësohet se meqë Policia ka rrjetë funksionale në tërë territorin ku operon, atëherë edhe sistemet si: SIPK-u, BMS-ja, etj, kanë shtrirje në të gjitha nivelet e organizimit policor (DPP, DRP, stacione, pika kufitare).

3.1.11. Në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore brenda organizatës, pika 1.3.3. e Planit të Veprimit ka përcaktuar aktivitete në 'identifikimin dhe përgatitjen e trajnerëve për Policinë në Bashkësi'. Sipas informacionit të dhënë nga Koordinatori¹¹, brenda vitit të parë të realizimit të këtij Plani janë identifikuar, trajnuar dhe certifikuar gjithsej 18 trajnerë. Trajnimet e tilla janë mbështetur nga Policia e Turqisë, Drejtorja e Trajnimeve të PK-së dhe OSBE-ja. Sipas të dhënave të DT-së¹², deri tani kanë arritur të trajnohen gjithsej 49 zyrtarë policorë si trajnerë për Policinë në Bashkësi.

¹⁰ DTI, *Raporti informues mbi Strategjinë për Policimin në Bashkësi*, 21.09.2015.

¹¹ Koordinatorin për Implementim dhe Monitorim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2012-2016 për Policimin në Bashkësi, *Raport informues mbi aktivitetet e realizuara nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për Policimin në Bashkësi*, nr. DDO-04/009/2013, datë 22.01.2013, Prishtinë.

¹² DT, *Raportimi mbi Implementimin e Strategjisë për Policimin në Bashkësi dhe Planit të Veprimit 2012-2016*, nëntor 2015, Prishtinë.

3.1.12. Pika 1.3.4. e Planit të Veprimit ka përcaktuar që të 'hartohet Programi për trajnimin themelor për punën në komunitet' dhe bazuar në detyrën e dhënë, Policia në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë (OSBE-në dhe ICITAP-in) ka nxjerrë një Program trajnimi për policinë në komunitet. Ky Program është aprovuar në muajin gusht të vitit 2012 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, pas kërkesës së drejtuar nga Kryesuesi i Grupit punues për rifreskim të Kursit Themelor për Policinë e Përgjithshme¹³. IPK-së i është prezantuar një Program trajnues i nxjerrë në gusht të vitit 2012¹⁴, që mund të përdoret për dy qëllime: për trajnimin e policëve të inkuadruar në PK dhe për trajnimin themelor për policët e rinj.

3.1.13. Pika 1.3.5. e Planit të Veprimit ka përcaktuar që për realizimin e tij është i nevojshëm 'organizimi dhe mbajtja e trajnimit për të gjithë zyrtarët policorë'. Sipas informacionit të dhënë nga Koordinatori, vetëm gjatë vitit të parë të realizimit të Planit është arritur që këtë trajnim ta ndjekin 2.170 zyrtarë policorë. Më pas, bazuar në të dhënat e siguruara nga DT-ja, në të gjitha DRP-të janë mbajtur trajnimet për policinë në bashkësi dhe trajnimi i tillë ka zgjatë dy ditë e gjysmë (2.5 ditë). Këtij trajnimi i janë nënshtruar 5.300 zyrtarë policorë. Ky trajnim ka qenë i obligueshëm për të gjithë zyrtarët policorë dhe i njëjti është zgjatur për katër (4) ditë si modul i veçantë për Trajnimin Themelor për Policinë e Përgjithshme.

3.1.14. Plani në pikën 1.3.6. ka përcaktuar që 'në kuadër të trajnimit themelor për policë, të përfshihen edhe module të veçanta për komunitet'. Raporti i siguar nga DT-ja dëshmon se në kuadër të trajnimit themelor për policinë e përgjithshme, ka hyrë si modul i veçantë edhe trajnimi për policinë në bashkësi, modul ky që ka tetë (8) njësi mësimore me gjithsej 28 orë trajnimi. Temat e përfshira në modul janë: bashkësia- çka janë bashkësitë dhe kuptimi i tyre (2 orë); parimet e policimit dhe siguria në bashkësi (2 orë); ndërtimi i partneritetit (5 orë); zgjidhja e problemit (6 orë); shkathtësitë komunikuese (4 orë); policia e udhëhequr nga inteligjenca dhe policimi në bashkësi (2 orë); hapat për zbatimin e policimit në bashkësi (2 orë); strategjia e policisë në bashkësi, plani i veprimit PSO-ja dhe parimi P-5.12 (5 orë).

3.1.15. Konform pikës 1.3.7. të Planit, që ka përcaktuar 'kryerjen e analizës dhe identifikimin e nevojave për trajnime të specializuara për komunitet', DT-ja në bashkëpunim me DPBP-në, në fund të vitit 2014 ka kryer një analizë dhe ka identifikuar nevojat për trajnime për vitin 2015. Mbi këtë analizë, DT-ja ka nxjerrë një dokument, në të cilin janë përfshirë trajnimet e të gjitha fushave¹⁵. Analiza mbi nevojat trajnuese të personelit është bazuar në hulumtime kualitative dhe kuantitative. Duke përfshirë trajnime të shumë fushave dhe niveleve, identifikimi i nevojave është ndërmarrë nga DT-ja me qëllim që të ndihmohet PK për të qenë më efikase, efektive dhe profesionale në kryerjen e detyrave policore, por edhe plotësimin e zbrazëtirave të mundshme që mund të tejkalohen përmes ndjekjes së trajnimeve adekuate.

3.1.16. Për të vlerësuar nivelin e përmbushjes së detyrës 1.3.8. të Planit 'mbi mbajtjen e trajnimeve të specializuara', IPK-ja ka siguruar të dhëna nga DT-ja, sipas të cilave, që nga viti 2012 kur ka filluar së zbatuari Plani i Veprimit për Strategjinë e Policimit në Bashkësi, deri në qershor të këtij viti, janë mbajtur nëntë (9) lloje trajnimesh për policinë në komunitet, me një përfshirje prej 218 të trajnuarish. Është organizuar një (1) seminar, në të cilin ka marrë pjesë një

¹³ Kryesuesi i Grupit punues për rifreskim të Kursit themelor për Policinë e Përgjithshme, *Kërkesë për aprovimin e Kursit themelor për Policinë e Përgjithshme*, DPPK-01/930/2012, 09.08.2012, Prishtinë.

¹⁴ DT, *Kurs themelor për policinë e përgjithshme*, gusht 2012, Prishtinë.

¹⁵ DT, *Raporti- Analiza e nevojave për trajnim për vitin 2015*, dhjetor 2014, Prishtinë.

numër prej 281 zyrtarëve policorë, katër (4) lloje punëtorish me gjithsej 183 pjesëmarrës dhe një (1) seminar jashtë vendit, në cilin ka marrë pjesë një (1) zyrtar policor.

3.1.17. Në përmbushjen e detyrës 1.3.9. të Planit që lidhet me 'plotësimin e plan-programeve trajnuese për udhëheqje, menaxhment, me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin', DT-ja e mbështetur nga partnerët ka nxjerrë një Program trajnues për policinë në komunitet sipas nivelit të udhëheqjes. Ky Program është ndarë në shtatë (7) module dhe për secilin nivel udhëheqës janë ndarë nga gjashtë (6) orë. Moduli i II-të 'policimi në bashkësi' është pjesë e menaxhimit të vijës së parë të menaxhimit (për rreshter), moduli i III-të është pjesë e menaxhimit të mesëm (për toger), moduli i IV-të është pjesë e menaxhimit për kapiten, kurse modulet V dhe VI janë pjesë e menaxhimit të lartë (për major e lartë). IPK-së i janë prezantuar katër (4) kërkesa të Drejtorisë për Mbështetje të Trajnimeve për aprovim të plan- programeve (e para, me ref. 07/02-03/123/14, datë 14.04.2014, e dyta, me ref. 07/02-03/131/14, datë 18.04.2014, e treta, me ref. 07/02-03/145/14, datë 29.04.2014 dhe e katërta, me ref. 07/02-03/146/14, datë 29.04.2014). Plan-programet e modifikuara për udhëheqje dhe menaxhment janë aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përfshirë atë për rreshter¹⁶, për toger¹⁷, për kapiten¹⁸ dhe për major e më lartë¹⁹.

3.1.18. Realizimi i Strategjisë për Policimin në Bashkësi kërkon edhe përvoja të vendeve që kanë jetësuar këtë koncept policimi. Plani i Veprimit në pikën 1.3.10. ngarkon DT-në, DPBP-në që në mbështetje nga partnerët 'të organizojë vizita studimore në vendet që aplikojnë strategji të policimit në bashkësi'. Sipas informacionit të siguruar nga DT-ja, deri më tani janë realizuar dy (2) vizita studimore jashtë vendit, në shtetet që aplikojnë strategji të tillë. Vizita e parë është realizuar përmes OSBE-së në Irlandë, ku PK-ja është përfaqësuar nga 11 zyrtarë policorë. Vizita e dytë studimore është realizuar në Austri, nga vetë PK-ja dhe aty kanë marrë pjesë shtatë (7) zyrtarë policorë.

3.1.19. Policimi në Bashkësi si një koncept i ri policimi është synuar të promovohet përmes rrugëve të ndryshme të vetëdijesimit. Pika 1.4.1. e Planit ka përcaktuar 'lansimin e fushatave senzibilizuese përmes medieve lidhur me Strategjinë'. IPK-ja ka siguruar informacionin nga Koordinatori dhe ZIMP-i, sipas të cilave vërehet se në vazhdimësi nuk kanë munguar angazhimet në lansimin e fushatave senzibilizuese. Në vitin e parë të zbatimit të Strategjisë janë organizuar një varg aktivitete promovuese, me një përfshirje të ZIMP-it (qendror e rajonal), DPBP-së dhe partnerëve tjerë, qoftë OJQ-ve por dhe mekanizmave ndërkombëtarë. Aktivitetet kanë përfshirë: promovimin medial të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, nxjerrjen dhe shpërndarjen e broshurave të ndryshme, emetimin e spoteve televizive, organizimin e debateve televizive, publikimin e shkrimeve në revistën policore 'Mbrojtësi', organizimin e konferencave për shtyp dhe aktivitete tjera promovuese. Në vitet vijuese nuk kanë munguar aktivitetet promovuese të këtij koncepti. Me iniciativë të DPBP-së, në qershor dhe korrik të vitit 2013 është realizuar një projekt nga ZIMP-i në bashkëpunim me DRP-të, ku zëdhënësit rajonalë së bashku me koordinatorët rajonalë të policisë në komunitet dhe shefat e sektorëve kanë marrë pjesë në 22 emisione radio televizive, me synimin për të njoftuar opinionin mbi konceptin dhe qëllimin e policimit në komunitet. Shkrimet në revistën policore, publikimet e posterëve dhe shpërndarjet e broshurave po ashtu nuk kanë munguar. Gjatë vitit 2014 janë lëshuar 73 komunikata, janë

¹⁶ DPP, *Plan- programi i trajnimit për 'menaxhim të vijës së parë'*, nr. 01/547, 16.04.2014, Prishtinë.

¹⁷ DPP, *Plan- programi i trajnimit për 'menaxhimin e mesëm'*, nr. 01/593, 24.04.2014, Prishtinë.

¹⁸ DPP, *Plan- program i trajnimit 'Menaxhimi për kapiten'*, nr. 01/633, 30.04.2014, Prishtinë.

¹⁹ DPP, *Plan- program i trajnimit 'Menaxhimi lartë'*, nr. 01/631, 30.04.2014, Prishtinë.

regjistruar dhjetë (10) prononcime për media, janë evidentuar tri (3) fushata dhe 13 aktivitete tjera nga ZIMP-i. Një angazhim i theksuar është vërejtur edhe në fushën e ngritjes së sigurisë së përgjithshme, me theks të veçantë rreth sigurisë në trafik, me një rol të dukshëm të partnerëve ndërkombëtarë (OSBE-ja, KFOR-i).

3.1.20. Pika 1.4.2. e Planit ka përcaktuar 'publikimin e Strategjisë në faqen zyrtare të PK-së. Gjatë vizitës që i ka bërë kësaj faqeje zyrtare, IPK-ja ka vërejtur se ajo përmban edhe publikimin e këtij dokumenti, të cilin mund ta ketë në dispozicion opinionin publik për t'u njoftuar për konceptin e ri të policimit. Kjo faqe elektronike zyrtare përmban dy (2) hapësira (dritare) të veçanta ('policimi në bashkësi' dhe 'dokumente'), ku janë prezantuar një numër broshurash, posterësh, projektesh dhe shkrimesh që lidhen me këtë koncept. Të gjitha këto dokumente që lidhen me policimin në bashkësi janë të publikuara dhe mund të gjenden edhe përmes rrjetit social 'facebook', në faqen zyrtare të PK-së.

3.1.21. Pika 1.4.3. e Planit të Veprimit ka përcaktuar 'informimin e zyrtarëve policorë të të gjitha niveleve organizative mbi Strategjinë'. Para se të hartohet dokumenti strategjik i policimit, PK-ja ka filluar në bashkëpunim me partnerët strategjikë ndërkombëtarë të testoj mundësitë për aplikimin e konceptit të policimit në bashkësi. Në këtë fazë janë përfshirë disa stacione dhe pas disa rezultateve pozitive të dala në pah, është arritur në përfundimin se aplikimi i këtij koncepti është i mundshëm dhe i nevojshëm për organizatën. Më pastaj, ka pasuar nxjerrja e dokumentit strategjik mbi policimin në bashkësi, si udhërrëfyes për një mision të mundshëm. Në takimet e zhvilluara me menaxherë të stacioneve, IPK-ja është informuar se para fillimit të zbatimit të Strategjisë janë njoftuar të gjitha nivelet policore mbi Strategjinë. Bazuar në detyrat e ndara me Plan të Veprimit, janë përgatitur trajnerët dhe janë kryer trajnimet e nevojshme me një përfshirje të gjerë të zyrtarëve policore. Koncepti i ri është përcjellë edhe me vizita studimore në vende që aplikojnë këtë koncept të policimit. Tërë këto angazhime janë përcjellë edhe me fushata të vetëdijesimit për filozofinë e re të policimit, duke mos lënë anash edhe vizitat e shumta në terren, të kryera nga Grupi për Zbatim e Monitorim nëpër drejtoritë rajonale policore dhe stacionet policore.

3.2. Vlerësimi i veprimeve policore në avancimin e partneritetit me bashkësinë, si parakusht për zhvillimin e policimit efektiv, demokratik, të nevojshëm për të rritur sigurinë, qetësinë, lirinë e lëvizjes dhe cilësinë e përgjithshme të jetës për të gjithë qytetarët

3.2.1. Duke iu referuar të dhënave të Raportit të Koordinatorit, në drejtim të përmbushjes së pikës 2.1.1. të Planit që përcakton 'identifikimin e partnerëve në nivel qendror, roli i të cilëve lidhet me Strategjinë', PK-ja ka identifikuar një numër të konsiderueshëm të tyre. Në mesin e partnerëve në nivel vendor duhet potencuar institucionet qendrore (MPB, MAPL, MASHT, Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Kryeministrit), komunat, forumet e sigurisë, mediumet informative (RTK, RTV21), OJQ-të e ndryshme, partnerët ndërkombëtarë (Oda Ekonomike Amerikane, ICITAP, OSBE). Sipas një Raporti njoftues të prezantuar nga DPBP-ja, mbi partnerët vendorë e ndërkombëtarë²⁰, listës së mëhershme të partnerëve i janë shtuar edhe partnerët tjerë si: Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze, Misioni i UNDP-së në Kosovë, KFOR-i, organizatat ndërkombëtare ('Terre des homes', 'Forum ZDF', 'Safer world'), OJQ-të vendore ('QKSS', 'FIQ', 'KEC', 'FRP', 'Labirinti', 'Syri i vizionit'), etj.

²⁰ DPBP, *Partnerët vendorë e ndërkombëtarë*, 14. 09.2015, Prishtinë.

3.2.2. Pika 2.1.3. e Planit përcakton që të bëhet ‘identifikimi i partnerëve në nivel lokal’, roli i të cilëve i kontribuon arritjes së objektivave të Strategjisë. IPK-ja ka siguruar informacione mbi angazhimet në identifikimin e partnerëve të mundshëm. Me gjithë mundësinë që kanë patur stacionet dhe DRP-të për të prezantuar numrin e saktë të tyre, nuk kanë arritur të prezantojnë qartë numrin e tyre, meqë informacioni i pasqyruar ka rezultuar të jetë shumë përmbledhës. Duke munguar qasja analitike në prezantimin e partnerëve, IPK-ja nuk ka arritur të sigurojë Listë të saktë të tyre. Përgjithësisht kjo detyrë nuk është kuptuar qartë sa duhet, ngase identifikimi i partnerëve nënkupton gjetjen e partnerëve që kanë shprehur gatishmërinë të ofrojnë bashkëpunim dhe partneritet me Policinë. Vërehet se pjesa dërmuese e stacioneve kanë filluar me përmbushjen e kësaj detyre që në fillim të jetësimit të Strategjisë, kurse një numër prej 13 sosh ka filluar me vonesë identifikimin e partnerëve. Disa prej tyre kanë filluar në vitin 2013 e një pjesë e tyre në vitin 2014. Bazuar në formularët e inspektimit, është një numër prej 14 stacionesh, që nuk kanë prezantuar burimin e informacionit për këto aktivitete, gjë që bën që aktivitetet e tilla të mos mbështeten me dokumentacion përcjellës.

3.2.3. Pika 2.1.4. e Planit përcakton ‘institucionalizimin e partneritetit në nivel lokal’. IPK-ja ka siguruar nga DPBP-ja informacionin mbi numrin e forumeve të sigurisë, përfshirë KLSP-të dhe EVSB-të. Sipas tyre, numri i forumeve është në rritje dhe ka arritur në gjithsej 90, ku prej tyre 54 janë KLSP dhe 36 EVSB (në kuadër të DRP-së së Mitrovicës Veriore nuk ka EVSB të themeluar). Një numër i KLSP-ve janë themeluar para fillimit të jetësimit të Strategjisë. Partneriteti dëshmohet edhe me mbajtjen e takimeve ku paraqiten shqetësimet e komunitetit mbi problematika të ndryshme. Vërehet numri në rritje i takimeve të realizuara me partnerët e identifikuar, nga 679 që ishte në vitin e parë, në 1031 takime në vitin 2014 (viti 2015 nuk është përfshirë në krahasim për shkak se nuk është vit me shënime të plota). DRP e Prizrenit prinë me numrin më të madh të takimeve të realizuara me partnerët. Tendencë të rritjes ka edhe ‘numri i planeve dhe projekteve të realizuara në partneritet me komunitetin’, nga 136 sa ka qenë për vitin 2012, në 246 në vitin 2014 (edhe këtu nuk është përfshirë krahasimi me vitin 2015). Në tabelën në vijim pasqyrohet numri i planeve dhe projekteve (shih tabelën nr. 1, me të dhëna të stacioneve dhe DRP-ve).

Aktivitetet	Numri i takimeve dhe projekteve sipas viteve			
	2012	2013	2014	2015
Takime të mbajtura me partnerët lokalë	679	868	1031	894
Plane dhe projekte të realizuara	136	154	246	210

3.2.4. Pika 2.2.2. e Planit ka përcaktuar ndërmarrjen e hapave nga DPP-ja, shtyllat, DPBP-ja, ZIMP-ja, DRP-të, stacionet dhe nënstacionet në ‘angazhimin e vullnetarëve praktikant në zgjidhjen e problemeve dhe qytetarëve të shenjësuar me jelekë flouroscent, që ndihmojnë Policinë në raste jo-emergjentë’. Edhe pse ky aktivitet është paraparë të ndërmerret nga viti 2013, disa DRP kanë filluar së zbatuari që në vitin e parë të jetësimit të Strategjisë. DRP e Mitrovicës Veriore nuk ka asnjë aktivitet të evidentuar. Kur i referohemi tabelës me të dhëna të menaxherëve të stacioneve dhe koordinatorëve rajonalë, shihet se nga viti në vit ka një tendencë të ngritjes së ‘numrit të qytetarëve’ dhe ‘grupeve të përfshira’. ‘Numri i qytetarëve’ është rritë nga 122 në 346 në vitin 2013 dhe 562 në vitin 2014. Njëjtë është ngritë edhe ‘numri i grupeve të përfshira’ nga 24, në 107 në vitin 2013 dhe 140 në vitin 2014.

Tabela nr. 2. Përmbledhje tabelore e aktiviteteve policore në angazhimin e vullnetarëve praktikantë që ndihmojnë Policinë në situata jo-emergjente (nëntor 2015)				
Qytetarët/ grupet	Numri i qytetarëve dhe grupeve sipas viteve			
	2012	2013	2014	2015
Qytetarë të përfshirë	122	346	562	446
Grupe të përfshira	24	107	140	120

3.2.5. Plani i Veprimit në pikën 2.2.3 ka ngarkuar me përgjegjësi Koordinatorin dhe Grupin Punues që të 'themeloj Grup punues për ndarjen e mirënjohjeve për qytetarë, forume dhe policë, për kontribut të ofruar për sigurinë në komunitet'. Bazuar në informatat e Raportit Njoftues të Koordinatorit mbi aktivitetet e Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim²¹, në dhjetor të vitit 2012, është themeluar Grupi punues për identifikimin e të gjithë partnerëve për aktivitete të dalluara në këtë proces. IPK-së nuk i është prezantuar dëshmi për Grupin e themeluar, mirëpo detyra i është besuar vetë Grupit për Zbatim dhe Monitorim. Partnerët e identifikuar për kontributin e dhënë janë propozuar për t'u shpërblyer tek niveli i lartë menaxherial dhe në një ceremoni rasti të fund vitit, janë ndarë mirënjohje për punën e dalluar. Nuk është siguruar informacioni që ky Grup do të jetë i përhershëm dhe nëse do të shpërblejë edhe në të ardhmen akterët lidhur me kontributin e dhënë. Po ashtu, nuk janë siguruar informata mbi numrin e partnerëve, të cilëve u janë shpërndarë mirënjohje.

3.2.6. Pika 2.3.1. e Planit përcakton se është i nevojshëm 'organizimi i takimeve, seminareve, tryezave me komunitetin dhe OJQ-të'. IPK-ja ka siguruar të dhëna nga të gjitha DRP-të dhe stacionet mbi aktivitetet e zhvilluara në raport me komunitetin. IPK-ja ka prezantuar këto të dhëna duke konsideruar se janë siguruar nga niveli lokal ku edhe zhvillohet pjesa më e madhe e aktiviteteve që lidhen me Strategjinë. Në këtë tabelë janë paraqitur aktivitetet e përgjithshme në rënie, të DRP-ve dhe stacioneve, duke përfshirë takimet, seminarët, tryezat dhe konferencat e organizuara (nga 1236 në vitin 2012, në 989, përkatësisht 952 në vitet 2013 dhe 2014). DRP e Mitrovicës Veriore në dy vitet e para nuk ka evidentuar asnjë aktivitet. Me gjithë faktin se ka pasur në vazhdimësi angazhime në ngritjen e partneritetit me komunitet, prezantimi i të dhënave nuk besohet të jetë i qëndrueshëm, meqë mospërputhja e të dhënave nga niveli rajonal/lokal me atë qendror është evident.

Tabela nr. 3. Paraqitja e aktiviteteve me komunitetin në nivel rajonal e lokal (nëntor 2015)				
Aktivitetet me komunitet (takime, seminare, tryeza)	Numri i aktiviteteve sipas viteve			
	2012	2013	2014	2015
Gjilan	139	140	159	156
Prishtinë	91	133	142	120
Mitrovicë Jugore	24	41	33	36
Prizren	121	154	211	218
Ferizaj	37	33	46	93
Mitrovicë Veriore	0	0	62	31
Gjakovë	664	337	119	342
Pejë	160	151	180	194
Gjithsej	1236	989	952	1190

²¹ Koordinatorin për Implementim dhe Monitorim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2012-2016 për Policimin në Bashkësi, *Raport informues mbi aktivitetet e realizuara nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për Policimin në Bashkësi*, nr. DDO-04/009/2013, datë 22.01.2013, Prishtinë.

3.2.7. Pika 2.3.2. e Planit të Veprimit parasheh ‘prezantimin e mundësive që ofron PK-ja për komunikim të sigurt dhe të besueshëm me komunitetin’. IPK-ja ka kontrolluar raportet vjetore të Koordinatorit për vitet 2012, 2013 dhe 2014, por nuk ka gjetur se kjo fushë është trajtuar në mënyrën e duhur, ngase kjo pikë duhet të qartësohet në mënyrë që PK-ja duhet të ofrohet me komunitetin dhe t’i qaset atij duke i ofruar disa mundësi se si dy palët mund të komunikojnë lirshëm, sigurt dhe besueshëm. IPK-ja ka bashkëpunuar me PK-në për të qartësuar se si duhet të perceptohet kjo detyrë në të ardhmen. Për t’u qartësuar kjo pikë, është e nevojshme të kuptohet se tek termi ‘prezantim i mundësive’ duhet shtrohet çështja se cilat janë mundësitë që i prezantohen komunitetit që komunikimi të jetë i mundshëm me ta. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, stacionet dhe DRP-të kanë nxjerrë të dhëna statistikore mbi disa nga mundësitë që ka ofruar PK-ja për komunikim të duhur me qytetarët në adresimin e brengave të tyre. Mundësitë që ka prezantuar PK-ja për një komunikim cilësor kanë qenë: takimet me qytetarë, njoftimet përmes broshurave dhe posterëve, paraqitjet mediale dhe prezantime tjera. Edhe pse është vlerësuar që të ndërmerret si hap në vitin 2012, PK vazhdon edhe më tej që t’i ofroj mundësi komunitetit për mënyrat e komunikimit dhe bashkëpunimit.

3.2.8. Pika 2.3.4. e Planit të Veprimit përcakton ‘organizimin e ligjëratave në shkollat fillore dhe të mesme për vetëdijesimin e nxënësve lidhur me pasojat nga përdorimi i narkotikeve, rrezikut nga armët, pasojat nga trafikimi me njerëz dhe sigurisë në trafik’. Të dhënat e siguruar nga plotësimi i formularëve standard të inspektimit ka nxjerrë në pah se gjatë periudhës sa është në zbatim Strategjia e Policimit në Bashkësi, është në rritje numri i ligjëratave të realizuara nga stacionet dhe DRP-të (nga 266 në vitin 2012, në 402 dhe 603 në vitet 2013 dhe 2014). Të dhënat e nivelit lokal/ rajonal mbi numrin e ligjëratave të realizuara nuk janë në përputhje me ato të publikuara nga niveli qendror. DRP e Mitrovicës Veriore nuk ka të evidentuar asnjë aktivitet në dy (2) vitet e para të realizimit të Strategjisë²².

Tabela nr. 4. Përmbledhja tabelore e aktiviteteve vjetore policore në organizimin e ligjëratave në nivel rajonal dhe lokal (nëntor 2015)				
DRP-të (përfshirë stacionet)	Numri i ligjëratave të realizuara sipas viteve			
	2012	2013	2014	2015
Gjilan	108	118	103	84
Prishtinë	96	173	277	251
Mitrovica Jugore	7	11	16	17
Prizren	7	6	21	83
Ferizaj	18	21	28	33
Mitrovicë Veriore	0	0	28	24
Gjakovë	8	32	46	39
Pejë	22	41	84	34
Gjithsej	266	402	603	565

3.2.9. Pika 2.3.5. e Planit parasheh ‘informimin e qytetarëve në gjuhën e tyre amtare lidhur me mekanizmat e ankesave ndaj veprimeve policore’. Stacionet kanë shfrytëzuar të gjitha mundësitë që përmes takimeve me komunitetin të promovojnë mekanizmat ekzistues për trajtimin e ankesave të qytetarëve në lidhje me sjelljet e zyrtarëve policorë në raport me qytetarët dhe ligjin. Janë mbajtur takime formale me qytetarë që janë përkrahur nga OSBE-ja. Pjesëmarrësit janë njoftuar mbi procedurat e ankimit në rast kur qytetari vlerëson se i është shkelur një e drejtë nga radhët e Policisë. Sipas PK-së, në sportele ekzistojnë format për

²² Stacionet Policore të DRP-Veriu, në vitet e para të strategjisë kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në DRP-Jugu

parashtrim të ankesave nga qytetarët, në gjuhën shqipe e serbe. Njoftimet mbi mekanizmat e ankesave janë bërë përmes përfaqësuesve të bashkësive lokale, shpërndarjes së broshurave nëpër zona të përgjegjësive të stacioneve dhe DRP-ve, në të gjitha gjuhët e komunitetit. Sipas raportimeve të stacioneve, janë shpërndarë dhe ekspozuar në vende të dukshme posterë me mbishkrime 'raporto pa pagesë në numrin 080003333', janë shfrytëzuar takimet e drejtpërdrejta me qytetarë me qëllim të informimit mbi mundësitë e tyre në parashtrimin e ankesave. Mbështetur në të dhënat e stacioneve dhe DRP-ve, janë nxjerrë të dhëna mbi numrin e informatave të plasuara tek qytetarët mbi mekanizmat e ankesave. Shihet tendencë e ngritjes së 'numrit të informatave të plasuara mbi mekanizmat e ankesave', nga 219 sa ka qenë në vitin 2012, në 739 dhe 1027 në vitet 2013 dhe 2014. DRP e Pejës dhe Gjakovës identifikohen si drejtori me numrin më të madh të informatave të plasuara, kurse DRP e Mitrovicës Veriore²³ nuk ka evidentuar ndonjë aktivitet të tillë gjatë dy (2) viteve të para të jetësimit të Strategjisë.

Tabela nr. 5. Paraqitja tabelore e aktiviteteve policore të nivelit rajonal dhe lokal në plasimin e informatave tek qytetarët mbi mekanizmat e ankesave (nëntor 2015)				
DRP-të (përfshirë stacionet)	Numri i informatave të plasuara sipas viteve			
	2012	2013	2014	2015
Gjilan	18	25	49	60
Prishtinë	48	71	100	64
Mitrovicë Jugore	7	9	10	9
Prizren	0	18	49	62
Ferizaj	23	14	37	24
Mitrovicë Veriore	0	0	7	10
Gjakovë	0	508	630	250
Pejë	123	94	145	181
Gjithsej	219	739	1027	660

3.2.10. Pika 2.3.6. e Planit të Veprimit ka përcaktuar 'informimin e qytetarëve lidhur me statusin e rasteve të raportuara të raportuara në polici dhe njoftimin e tyre me veprimet e ndërmarra'. Bazuar në Raportet e Koordinatorit për vitet 2013/2014, janë zhvilluar aktivitete në vazhdimësi në mbajtjen e komunikimit aktiv me qytetarët mbi kthimin e informatave kthyesë mbi statusin e rasteve të raportuara. Për informimin e qytetarëve mbi statusin e rasteve dhe veprimet policore të ndërmarra, gjatë vitit 2013 janë dhënë nga PK-ja 170 informata kthyesë, derisa kjo shifër në vitin 2014 është ngritur në 809.

3.2.11. Me qëllim të përafrimit të komunitetit me PK-në, pika 2.3.7. e Planit të Veprimit ka përcaktuar 'organizimin e Portës së hapur me rastin e përvjetorit të ditës së themelimit të Policisë'. Sipas të dhënave të stacioneve, në dy vitet e para është vizituar gjysma e stacioneve policore, derisa në vitet 2014/2015, numri i stacioneve që janë vizituar në ditën e themelimit të PK-së është në rritje (22 e 23). Të dhënat në tabelë tregojnë për një trend pozitiv të ngritjes së numrit të vizitorëve që lidhen me ditën e themelimit dhe periudha tjera gjatë vitit. Në vitin 2012 dhe 2013, numri i stacioneve të vizituara ka qenë 20, derisa në vitin 2014 ka qenë 23. Numri i qytetarëve gjatë tri viteve të para që kanë vizituar stacionet gjatë portës së hapur ka qenë i ekuilibruar (1045, 1088 dhe 1181), kurse ka shënuar ngritje 'numri i qytetarëve që kanë vizituar stacionet gjatë ditëve tjera që nuk lidhen me ditën e Policisë (426, 819, 1232).

²³ Stacionet Policore të DRP-Veriu, në vitet e para të strategjisë kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në DRP-Jugu

Tabela nr. 6. Paraqitja tabelore e aktiviteteve lidhur me 'Portën e hapur' (nëntor 2015)				
Informata mbi vizitat e qytetarëve	Numri i qytetarëve sipas vitit			
	2012	2013	2014	2015
Stacionet e vizituara në ditën që lidhet me portën e hapur	20	20	23	22
Vizita në stacione që lidhet me ditën e policisë	1045	1088	1181	1187
Vizita në stacione në periudha tjera	426	819	1232	1438
Totali i vizitave të kryera në stacione policore	1471	1907	2413	2625

3.2.12. Plani në pikën 2.3.9. ka përcaktuar që 'MPB-ja, DPP-ja dhe Grupi punues, deri në dhjetor të vitit 2015 të 'themelojnë dhe të funksionalizojnë Muzeun policor'. Bazuar në Raportin për të arriturat dhe sfidat në zbatim të Strategjisë gjatë vitit 2014²⁴, DPBP-ja ka hartuar një projekt dokument për themelimin dhe funksionalizimin e Muzeut policor, që më 04.08.2014 është aprovuar nga Drejtori i Departamentit për Operacione. Projekti ka parapa funksionalizimin e tij në disa hapa (faza)²⁵: *së pari*, kryerjen e një hulumtimi duke marrë për bazë opinionet e qytetarëve mbi funksionalizimin e Muzeut; *së dyti*, organizimin e vizitës studimore rreth praktikave të funksionimit të Muzeut; *së treti*, furnizimin e Muzeut dhe caktimin e personelit; dhe *së katërti*, organizimin e fushatës për promovimin e Muzeut. Për të shtyrë para projektin, janë zhvilluar takime me përfaqësues të IAMK-së, DTK-së në kuadër të MKRS-së, OSBE-së, Sindikatës së PK-së, të OJQ-ve, DMO-së, Grupit themelues të Muzeut. Në bashkëpunim me DMO-në është caktuar lokacioni për Muzeun, kurse për të marrë opinionet e publikut mbi atë se si e shohin të ekspozuar atë, është zhvilluar hulumtim me përkrahje të 'Saferworld' dhe 'FRP-së, pjesë e të cilit kanë qenë 217 respondentë. Rezultatet janë publikuar në Raportin²⁶, që përfshin rezultatet e derivuara nga përgjigjet e dhëna në katër pyetjet e shtruar. Pas gjithë këtij angazhimi, nuk ka informacion se projekti është konkretizuar edhe pse mbetet ende kohë për një gjë të tillë.

3.2.13. Pika 2.4.1 parasheh 'identifikimin e vendeve që kërkojnë vendosjen e KLSP-ve në përputhje me Ligjin e Policisë dhe PSO-të'. IPK-ja ka siguruar informacionin nga DRP-të dhe stacionet, sipas të cilit edhe para fillimit të jetësimit të këtij koncepti, në mbështetje të Ligjit për Policinë janë themeluar forumet e sigurisë, siç janë KLSP-të. Sipas stacioneve policore, DRP-të dhe Zyra e Koordinatorit, deri më tani nga autoritetet lokale policore kanë arritur të identifikohen gjithsej 71 pika për vendosjen e KLSP-ve, por është arritur që nga ky numër, me vendim të DPP-së të themelohen 54 sosh. Numrin më të madh të tyre e ka DRP e Gjilanit me gjithsej 15 dhe DRP e Prishtinës me gjithsej 14 KLSP .

3.2.14. Pika 2.4.3. e Planit të Veprimit ka përcaktuar 'dizajnimin e një modeli unik raportues për ndërveprim policor me forumet e sigurisë', aktivitet ky i paraparë të kryhet deri në tetor të vitit 2012. IPK-ja ka siguruar një formular unik të raportimit të stacioneve policore mbi aktivitetet e KLSP-ve, që përmban informatat mbi numrin e takimeve, temat e trajtuara, partnerët pjesëmarrës dhe projektet e realizuara. Mbi bazën e këtyre informatave, DPBP-ja dhe Koordinatori nxjerrin raporte të veçanta mbi punën e KLSP-ve dhe nivelin e përmbushjes së detyrave që dalin nga Plani i Veprimit.

²⁴ Koordinatorin për Implementim dhe Monitorim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2012-2016 për Policim në Bashkësi, *Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2012-2016 për Policim në Bashkësi*, dhjetor 2014, Prishtinë.

²⁵ DPBP, *Projekt për themelimin dhe funksionalizimin e muzeut të Policisë së Kosovës*, 04.08.2014, Prishtinë.

²⁶ Saferworld, *Raport me rezultatet e opinionëve të qytetarëve mbi themelimin e Muzeut Policor të Kosovës*, 03.11.2014, Prishtinë.

3.2.15. Pika 2.4.4. e Planit të Veprimit përcakton 'respektimin e zinxhirit komandues në raportimin e aktiviteteve të KLSP-ve dhe EVSB-ve në DPBP'. IPK-ja është shërbyer me Raportet e Koordinatorit për vitet 2013/2014, sipas të cilave gjatë vitit 2013 janë raportuar gjithsej 70 takime të KLSP-ve derisa në vitin 2014, ky numër është ngritë në 105 takime të tilla. Kurse, sa i përket takimeve të EVSB-ve, këto shifra sillen prej 10 sa ishin në vitin 2013, në 22 në vitin 2014. Në takimet e tilla janë trajtuar brengat apo shqetësimet e qytetarëve në periodat raportuese, projektet me partnerët dhe temat tjera me rëndësi.

3.2.16. Pika 2.4.5. e Planit ka përcaktuar se 'komandantët e stacioneve iniciojnë takimet e KLSP-ve dhe EVSB-ve në mënyrë që të shkëmbejnë informata'. Sipas informatave të DRP-ve dhe stacioneve të publikuar ne Raportet e Koordinatorit për vitet 2013 dhe 2014, shihet se gjatë vitit 2013 janë mbajtur 100 takime të forumeve të sigurisë, prej të cilave, 70 takime të KLSP-ve dhe 30 takime të EVSB-ve. Për shkak të rritjes së numrit të këtyre forumeve, numri i takimeve të forumeve të sigurisë ka arritur në 169 në vitin 2014, prej të cilave 156 takime të KLSP-ve dhe 13 takime të EVSB-ve.

3.2.17. Pika 2.4.6. e Planit përcakton që 'komandantët e stacioneve sigurojnë që të gjithë sektorët të zhvillojnë dosjet e sektorëve që përfshijnë vendndodhjet dhe anëtarësimet e forumeve të sigurisë'. IPK-ja ka siguruar informacionin e nevojshëm dhe ka vërejtur se në kuadër të 40 stacioneve policore janë të strukturuar gjithsej 139 sektorë. Edhe pse është e paraparë që të gjithë këta sektorë të kenë të krijuara dosjet sektoriale, vetëm Stacioni Policor i Zveçanit në kuadër të DRP-së së Mitrovicës Veriore nuk ka krijuar dy dosje sektoriale nga tre sa janë paraparë. Kjo nënkupton se deri më tani për 139 sektorë janë krijuar gjithsej 137 dosje sektoriale. Stacionet kanë prezantuar edhe numrin e forumeve të sigurisë dhe numrin e anëtarëve të forumeve të sigurisë, por meqë numri i tyre është i ndryshueshëm, IPK-ja ka vlerësuar se nuk paraqesin ndonjë relevancë shifrat e tilla, pasi kjo pikë i referohet më tepër dosjeve sektoriale. Ngecjen e krijimit të këtyre dosjeve, Stacioni Policor i Zveçanit e arsyeton me ngecjen në caktimin e udhëheqësve të sektorëve. IPK-ja ka kontrolluar disa nga dosjet sektoriale të disa stacioneve dhe ka vërejtur se brenda tyre janë të mirëmbajtura kënaqshëm të dhënat mbi forumet e sigurisë, përfshirë aktivitetet, përbërjen e tyre, etj.

3.2.18. Pika 2.4.7. e Planit parasheh 'angazhimin e rregullt të udhëheqësve të sektorëve, në identifikimin personal të tyre para publikut dhe sqarimin e roleve dhe përgjegjësi të tyre'. Është evidentuar aktivitet në sektorë në organizimin e takimeve formale me komunitetin, ku është synuar të prezantohet roli policor por edhe përgjegjësitë në jetësimin e Strategjisë. Prezantimet e tilla janë shprehur në ofrimin e informatave mbi mundësitë e komunikimit të përbashkët me komunitetin për të mbështetur partneritetin. Janë evidentuar aktivitete në shpërndarjen e broshurave, përmes të cilave është synuar vetëdijësimi i publikut mbi bashkëpunimin si vlerë. Vlen përmendur, realizimin edhe të projekteve tjera përmes të cilave janë dhënë sinjale për bashkëpunim dhe partneritet me komunitetin ('Njiheni policin tuaj', 'Vizito dhe bisedo'). Numri i këtyre takimeve të udhëheqësve policorë me komunitetin (periudha 2013-2015), në të cilat janë sqaruar rolet, përgjegjësitë e akterëve, përfshirë Policinë, por edhe identifikimi personal i tyre, ka shënuar rritje nga viti në vit. Në vitin e parë është parë një angazhim më i theksuar për shkak të fillimit të jetësimin të Strategjisë, atëherë kur informimi i komunitetit ka qenë i mirëseardhur për shkak të njohurive jo të mjaftueshme mbi konceptin e policimit. Duke përcjellë lëvizjen e numrit të takimeve nga viti 2013 deri tani, vërehet një angazhim në përafrimin me komunitetin, ngase takimet kanë kaluar në kuotat 2223, 2454 deri 2613. Në dy vitet e para të realizimit të Strategjisë, DRP e Mitrovicës Veriore nuk ka evidentuar

asnjë angazhim të tillë. Meqë këto paraqesin aktivitete dinamike, raportimet e stacioneve nuk janë në përputhje me ato të Koordinatorit (viti 2014).

Tabela nr. 7. Paraqitja tabelore e aktiviteteve në identifikimin personal të zyrtarëve policorë para publikut (nëntor 2015)				
Takimet/kontaktet me komunitetin sipas DRP-ve	Numri i takimeve/kontakteve sipas viteve			
	2012	2013	2014	2015
Gjilan	108	179	257	280
Prishtinë	62	98	161	188
Mitrovicë Jugore	583	653	766	956
Prizren	1012	13	9	46
Ferizaj	114	183	204	205
Mitrovicë Veriore	0	0	5	17
Gjakovë	804	707	604	487
Pejë	411	390	453	434
Gjithsej	3094	2223	2454	2613

3.2.19. Plani i Veprimit në pikën 2.4.8. të tij ka përcaktuar që 'DPBP-ja organizon këshillat ekzekutive të KLSP-ve në intervale të rregullta siç nevojitet në përputhje me PSO-të aktuale dhe u përgjigjet ftesave të forumeve tjera të sigurisë'. Duke qenë një organ këshillues, koordinues dhe përkrahës për KLSP-të, Këshilli Ekzekutiv i KLSP-ve ka synuar të sigurojë rrjedhën e informatave me qëllim të shkëmbimit të përvojave më të mira. Duke pasur si prioritet përmirësimin e bashkëpunimit në mes të forumeve, Policisë dhe partnerëve, drejt ngritjes së shkallës së sigurisë dhe përmirësimit të kushteve jetësore, Këshilli Ekzekutiv i KLSP-ve ka organizuar përgjatë periudhës tre vjeçare 2012-2014, të realizimit të Strategjisë, gjithsej tetë takime punuese (3+3+2). Takimet e mbështetura nga OSBE dhe me pjesëmarrje edhe të ICITAP-it, UNDP-së, MPB-së, etj, kanë trajtuar sfidat, problemet dhe të arriturat e forumeve në angazhimet e tyre për zgjidhjen e brengave dhe shqetësimeve të komunitetit, që interferojnë në çështje të sigurisë dhe në mirëqenie të qytetareve.

3.2.20. Pika 2.4.9. e Planit të Veprimit 'përcakton që sipas nevojës trajnerët e sigurisë në komunitete (KLSP dhe EVSB trajnerët e trajnuar) përdoren nga PK-ja si pjesë e projekteve të vazhdueshme të sigurisë në komunitet dhe fushatave të ngritjes së vetëdijes në vende të ndryshme'. Me iniciativë të partnerëve ndërkombëtarë, janë trajnuar dhe certifikuar nga radhët e PK-së dhe komunitetit 225 trajnerë të sigurisë. Trajnerët e sigurisë janë trajnuar në këto fusha, si: identifikimi, analizimi dhe zgjidhja e problemeve të sigurisë në komunitet. Gjatë vitit 2013 vlerësohet kontributi i trajnerëve në 33 projekte të financuara nga Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze. Kurse në vitin 2014, këta trajnerë janë përfshirë në 63 fushata vetëdijesuese. Në mesin e të trajnuarve nga radhët e PK-së janë të certifikuar zyrtarë policorë që kryesisht aktiviteti i tyre lidhet me jetësimin e Strategjisë, përfshirë: zyrtarë të DPBP-së, komandantë të stacioneve, koordinatorë rajonalë të policimit në bashkësi, zyrtarë policorë të komunitetit, udhëheqës të sektorëve, zyrtarë për media, etj. DRP-të me numrin më të madh të këtyre trajnerëve të sigurisë janë: Gjilani (95), Prishtina (46), Peja (40), pasojnë Prizreni (16), Ferizaj (13), Mitrovica Jugore (7), Gjakova (6) dhe Mitrovica Veriore (2).

3.2.21. Pika 2.4.10. e Planit të Veprimit ka përcaktuar që 'forumet e sigurisë, veçanërisht KLSP-të dhe EVSB-të, shfrytëzohen nga PK-ja për të kontribuar në monitorimin e tensionit në komunitet, ngritjen e vetëdijes publike, si burim në mbledhjen e informatave mbi sigurinë e

komunitetit dhe inkorporon këto forume në aktivitete ndaj reagimit të emergjencave sipas nevojës'. IPK-ja ka nxjerrë të dhëna nga stacionet dhe DRP-të sipas të cilave shihet ngritje e 'numrit të forumeve të sigurisë' dhe të 'raportimeve mbi aktivitetet', siç ka ngritje edhe të 'numrit të njerëzve të përfshirë në aktivitete'. Numri i raporteve rreth sigurisë së komunitetit ka shënuar ngritje nga 143 sa ka qenë në vitin 2012, në 158 dhe 220 në vitet 2013 dhe 2014. Edhe 'forumet e sigurisë të përfshira në sigurinë e komunitetit' kanë shënuar ngritje nga 31 sa ka qenë në vitin 2012, në 36 dhe 57 në vitet 2013 dhe 2014. Numri i njerëzve të përfshirë në aktivitete ka osciluar lëvizje poshtë- lart. Edhe në këtë pikë, IPK-ja ka pasur në dispozicion raportet e Koordinatorit dhe ato të stacioneve, por meqë ato nuk përmbajnë të dhëna të përputhshme, ne jemi referuar në të dhënat individuale të siguruar nga stacionet dhe DRP-ve, që kanë derivuar nga plotësimi i formularëve standard të inspektimit (shih tabelën).

Tabela nr. 8. Përmbledhje tabelore e aktiviteteve vjetore të forumeve në ngritjen e sigurisë (nëntor 2015)				
Aktivitetet e forumeve të sigurisë	Periodha vjetore			
	2012	2013	2014	2015
Numri i raporteve rreth sigurisë së komunitetit	143	158	220	331
Numri i forumeve të përfshira në sigurinë në komunitet	31	36	57	67
Numri i njerëzve të përfshirë në aktivitete	590	562	785	968

3.2.22. Pika 2.4.11. e Planit ka përcaktuar 'krijimin dhe administrimin e Bazës së të dhënave për KLSP-të dhe EVSB-të, që përfshijnë liderët, informatat e kontaktit dhe aftësitë e tyre të specializuara'. IPK-ja ka vërejtur se tek udhëheqësit policorë lokal dhe rajonalë është krijuar paqartësi lidhur me atë se a kemi të bëjmë me Bazat fizike të forumeve të sigurisë apo edhe elektronike të integruara. Lidhur me krijimin e administrimin e bazave fizike të të dhënave për forumet e sigurisë është vërejtur se në kuadër të dosjeve sektoriale të stacioneve janë të inkorporuar edhe informatat mbi forumet e sigurisë, që përmbajnë informata mbi liderët, anëtarët e tyre dhe ato të kontaktit. Ekziston një numër stacionesh policore, që përveç dosjes fizike, kanë përgatitur edhe atë elektronike, por të cilat nuk janë të integruara në një sistem. Kjo pikë mbetet të qartësohet në të ardhmen dhe të punohet në atë drejtim që imponojnë nevojat dhe kjo të vlerësohet në bashkëpunim edhe me DTI-në. Kjo mund të ndikojë në rritjen e numrit të informatave mbi shqetësimet e qytetarëve, që vlerësojnë se komunikimi përmes këtyre sistemeve mund të jetë shumë më efikas dhe kontribuues. Kjo i referohet perceptcionit se në këtë mënyrë edhe qytetarët kanë nevojë për informacionin mbi forumet dhe të dhënat për liderët dhe anëtarët tjerë të forumeve të sigurisë.

3.2.23. Pika 2.4.13. e Planit të Veprimit ka përcaktuar se 'mbështetja për konceptin e KLSP-ve, EVSB-ve, KKS-ve, forumet tjera të sigurisë së komunitetit dhe partneritetit promovohen në mënyrë aktive nga të gjithë anëtarët e PK-së'. IPK-ja është interesuar të vlerësoj aktivitetet policore në promovimin e këtyre forumeve por edhe të vet konceptit. Bazuar në analizat e tilla të nxjerra nga Raportet e Koordinatorit shihet se aktivitetet janë në rritje dhe kjo bazohet në të dhënat, sipas të cilave, struktura policore gjatë vitit 2013 ka organizuar dhe mbajtur rreth 450 aktivitete, përfshirë takime, vizita dhe aktivitete tjera promovuese me qytetarë dhe grupe të interesit, në të cilat është promovuar koncepti i policimit në bashkësi, Strategjia, Plani i Veprimit, përfshirë edhe forumet e sigurisë. Ky numër i aktiviteteve në vitin 2014 ka arritur në gjithsej 1499 takime. Vlen përmendur se edhe në këtë pikë kanë ngecur stacionet policore të DP-së së Mitrovicës Veriore.

3.2.24. Pikat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.4. të Planit të Veprimit janë trajtuar nga IPK-ja si pika të ndërlidhura me njëra tjetrën, jo vetëm se informatat në mes të nivelit lokal dhe atij rajonal janë në mospërputhje me ato të nivelit qendror por edhe se fushë trajtimi kanë një natyrë të njëjtë problemore. Bazuar në raportet e Koordinatorit (2013/2014), numri i informatave të pranuar nga qytetarët ka pësuar rënie në këto dy periudha, nga 1200 në 562 në vitin 2014. Në anën tjetër, të dhënat e stacioneve dhe DRP-ve flasin për një performancë tjetër nga ajo që prezantohet në Raportin e Koordinatorit, sidomos për vitin 2014, derisa ato të vitit 2013, janë afërisht të përafërta. Pika 2.5.2 përcakton ‘analizimin e brengave të komunitetit dhe identifikimin e indikacioneve mbi problemet e mundshme’. Sipas Raportit të Koordinatorit për vitin 2014, numri i përgjithshëm i indikatorëve për probleme të mundshme apo krime potenciale në bashkësi është 13, në anën tjetër, stacionet dhe DRP-të kanë paraqitur shifra të ndryshme. Indikatorët më të shpeshtë janë cekur:: zhvillimi i ulët ekonomik, infrastruktura jo e duhur, niveli jo i duhur i edukimit, efikasiteti jo i duhur i institucioneve komunale dhe atyre të drejtësisë, normat tradicionale e shoqërore, etj. Prezantimi i ‘numrit të indikatorëve’ nga stacionet duket se në disa raste është i paqëndrueshëm, duke bërë me dije se ndoshta është i nevojshëm një komunikim më i qartë në mes niveleve rreth asaj se çka nënkuptohet me termin ‘indikatorë. Si rezultat i raportimit të brengave të qytetarëve, gjatë vitit 2014 janë identifikuar gjithsej 168 probleme. Raporti i Koordinatorit për vitin 2013 ka përmendur një numër problemesh të identifikuar, në mesin e të cilave edhe: vjedhjet, kontestet pronësore, moskujdesi ndaj qenve endacak, përdorimi i substancave narkotike, siguria në shkollë, posedimi dhe përdorimi i armëve, etj. Pika 2.5.4 ka përcaktuar ‘ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete në parandalimin dhe zvogëlimin e rrethanave që shkaktojnë problemin’. Sipas Raportit të Koordinatorit për vitin 2014, janë nxjerrë gjithsej 104 plane operative dhe janë ndërmarrë gjithsej 327 veprime operacionale. Është bërë shtimi i numrit të patrullimeve, zbatimi i planeve operative, projekteve vetëdijesuese, mbledhja e informatave inteligjente, për t’i kontribuar klimës për parandalimin e aktiviteteve kriminale. Duke bërë një vlerësim të aktiviteteve, IPK-ja ka qenë e sfiduar nga mungesa e informatave të qëndrueshme por edhe jo të mjaftueshme, duke iu referuar Raportëve të Koordinatorit që shpesh u mungojnë të dhënat statistikore por edhe të dhënave të stacioneve që japin përshtypjen se shpesh janë edhe të paqëndrueshme.

3.3. Vlerësimi i veprimeve policore që në partneritet me publikun të përfshihet në proceset e zgjedhjes së problemeve që identifikojnë, analizojnë dhe përgjigjen ndaj shqetësimeve të publikut

3.3.1. Pika 3.1.1 e Planit të Veprimit përcakton ‘identifikimin e zyrtarëve përgjegjës në kuadër të PK-së për avancimin e partneritetit me bashkësinë’. Bazuar në Raportin e Koordinatorit për vitin 2014, numri i përgjithshëm i zyrtarëve policorë që janë identifikuar për të avancuar partneritetin me qytetarët është 670. Sipas Raportit të Koordinatorit për vitin 2013, kjo shifër sillet në 300 zyrtarë policorë, në të cilin janë përfshirë zyrtarët policorë nga sektorët patrullues, udhëheqësit e sektorëve, koordinatorët e sektorëve, zyrtarët policorë të komunitetit, komandantët e stacioneve, koordinatorët rajonale për projekte, etj. Të dhënat që kanë derivuar nga plotësimi i formularëve të inspektimit, pasqyrojnë se numri i këtyre zyrtarëve në nivel lokal dhe rajonal arrin në rreth 670 zyrtarë që është e përputhshme me të dhënat e Koordinatorit për vitin 2014.

3.3.2. Pika 3.1.2. e Planit të Veprimit përcakton përfshirjen e qytetarëve, OJQ-ve e forumeve të sigurisë në zgjidhjen e problemeve’. Informacioni i prezantuar nga stacionet policore nuk është i

përputhshëm me të dhënat e Raportit të Koordinatorit, andaj këtu pasqyrojmë të dhënat e Raportit të Koordinatorit për vitin 2013 dhe 2014. Në vitin 2013, në aktivitete të zgjidhjes së problemeve janë përfshirë gjithsej 800 qytetarë, 11 OJQ dhe 33 forume të sigurisë, kurse në vitin 2014, në këto aktivitete janë përfshirë 524 qytetarë, 73 OJQ dhe 72 forume të sigurisë. Kemi rënie të "numrit të qytetareve të përfshirë në këto aktivitete" por në anën tjetër kemi ngritje të "numrit të OJQ-ve e forumeve të sigurisë të përfshirë në aktivitete" në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

3.3.3. Pika 3.1.3. e Planit të Veprimit ka përcaktuar 'caktimin e zyrtarëve policorë me qëllim të identifikimit të personave, grupeve dhe kategorive të ndjeshme që mund të jenë cak më i lehtë i sulmeve dhe viktimizimit'. Raporti i Koordinatorit për vitin 2014 sqaron se është regjistruar një numër prej 61 zyrtarësh policorë me qëllim të identifikimit të grupeve më të ndjeshme që mund të jenë cak i ndonjë sulmi. Këta zyrtarë kanë arritur të identifikojnë 131 persona dhe 43 grupe me ndjeshmëri. IPK-ja nuk ka arritur të sigurojë informatat nga Raportet e Koordinatorit për vitet 2012/2013 mbi numrin e këtyre qytetarëve dhe grupeve të identifikuar. Nga raportimet e kryera nga stacionet vërehet se tek kjo pikë është paraqitur hamendje se çfarë duhet prezantuar lidhur me 'numrin e zyrtarëve policorë të caktuar për identifikimin e personave, grupeve e kategorive të ndjeshme', ngase vlerësohet se nuk është kuptuar drejt detyra e dhënë me Plan.

3.3.4. Pika 3.2.2. e Planit të Veprimit parasheh 'raportimin e brengave të qytetarëve nga zyrtarët policorë tek njësitë përkatëse'. IPK-ja nuk ka arritur të sigurojë informacionin nga një numër stacionesh policore lidhur me këtë detyrë për shkak se detyra nuk është kuptuar qartë. Kjo lidhet edhe me faktin se informatat e stacioneve ndryshojnë në disa raste nga ato të raportuara tek Koordinatori. Bazuar në këto situata, IPK-ja është shërbyer me raportet e Koordinatorit për vitet 2013 dhe 2014. Sipas këtyre të dhënave, zyrtarët policorë gjate vitit 2013 kanë raportuar tek njësitë përkatëse, 234 brenga të qytetarëve, të realizuara përmes raportimeve policore, kurse në vitin 2014 ky numër është rritur në 482.

3.3.5. Janë trajtuar po ashtu edhe pikat që trajtojnë analizat mbi shqetësimet e qytetarëve dhe prioritetet në trajtimin e tyre. Pika 3.2.3 e Planit ka përcaktuar 'kryerjen e analizave mbi shqetësimet e qytetarëve mbi probleme të mundshme'. Në vazhden e ngritjes së sigurisë në bashkësi, Policia ka ndërtuar një sistem organizimi ku brengat e qytetarëve mund të adresohen në mënyra të ndryshme dhe të shumta. Ashtu, siç e proklamoi edhe vetë koncepti për policimin në bashkësi për rolin e komunitetit si aktor në ngritjen e sigurisë, qytetarët duke qenë partnerë kanë mundësinë e shprehjes së brengave të tyre por edhe ofrimin e informacionit lidhur me rrezikimin e sigurisë së përgjithshme. IPK-ja ka vërejtur se në drejtim të kultivimit të frymës së sigurisë, qytetarët kanë në duart e tyre disa mekanizma përmes të cilëve mund t'i adresojnë shqetësimet. Komuniteti mund të përdorë forumet e sigurisë për të trajtuar shqetësimet që i preokupojnë, mund të shfrytëzohen edhe takimet me zyrtarë policorë që mbulojnë sektorët përgjegjës, komunikimi përmes adresës elektronike info@kosovopolic.com, por edhe kutitë e informatave që janë të vendosura në kuadër të stacioneve policore. Kjo Drejtori nuk bën analiza të veçanta mbi shqetësimet e qytetarëve mbi problemet e mundshme. Të gjitha informatat e pranuar përmes adresës elektronike menaxhohen nga Qendra Operative e DPP-së, kurse DIA-s i adresohen ato informata që kanë të bëjnë me veprimtari kriminale, që më pas varësisht nga përmbajtja e tyre, adresohen tek departamentet përkatëse policore. Sipas Raportit të Koordinatorit për vitin 2014, numri i analizave të brengave dhe indikacioneve rreth problemeve potenciale të qytetarëve ka arritur në 641, numër ky që krahasuar me vitin 2013 (18 analiza) është shumë më i lartë.

3.3.6. IPK-ja ka trajtuar pikën 3.2.4 për të vlerësuar ‘aktivitetet në caktimin e prioriteteve për zgjidhjen e problemeve të adresuara nga shqetësimet e qytetarëve’. Duke konsideruar DIA-n si një akter me rëndësi në trajtimin e kësaj fushe, IPK-ja ka zhvilluar një takim me zyrtarë të saj. Duke iu referuar informatave të DIA-s, kjo Drejtori pranon kërkesa nga departamentet e ndryshme policore që kanë të bëjnë me hartimin e raporteve analitike mbi dukuritë e ndryshme kriminale, disa nga të cilat paraqesin edhe shqetësimet e qytetarëve. DIA përpilon në baza javore raport analitik²⁷, përmes së cilit jepet vlerësim i përgjithshëm i situatës së sigurisë në vend, identifikohen faktorët e mundshëm tensionues që mund të ndikojnë në situatën e sigurisë, si dhe jepen parashikime lidhur me atë se çfarë mund të pritet brenda një periudhe të caktuar kohore. Raporti iu dërgohet pothuajse të gjithë menaxherëve të lartë të PK-së. Nga ana tjetër, në nivel lokal, partneriteti me komunitet ofron mundësi të zgjidhjes apo trajtimit të brengave të qytetarëve. Policia lokale mund të trajtojë brengat e qytetarëve duke vendos prioritete në trajtimin e tyre qoftë përmes konkretizimit të planeve operative apo kanalizimit të problematikave tek akterë tjerë të përfshirë në partneritet. Sipas Raportit të Koordinatorit për vitin 2014, është shënuar në 206, ‘numri i prioriteteve’ në zgjidhjen e problemeve të bashkësisë, numër ky që është shumë më i madh në krahasim me numrin e prioriteteve për vitin 2013 (gjithsej 10).

3.3.7. Pika 3.2.5. e Planit parasheh ‘prezantimin e problemeve të zgjidhura si rezultat i bashkëpunimit të PK-së me komunitetin’. Bazuar në Raportet e Koordinatorit për vitet 2013 dhe 2014, gjatë vitit 2013 janë zgjidhur 783 raste në saje të bashkëpunimit me komunitetin. Ky numër në vitin 2014 është shumë më i vogël dhe sillet në 309 raste të zgjidhura. Edhe në këtë pikë janë vërejtur të dhëna të prezantuara që janë konsideruar si të paqëndrueshme nga disa stacione, të cilat kanë dhënë një pasqyre jo reale të aktiviteteve policore në këtë drejtim.

3.3.8. Plani i Veprimit për realizimin e Strategjisë së Policimit në Bashkësi përfshinë edhe Departamentin e Kufirit në mesin e akterëve që i janë ndarë detyra. Pika 3.3.1 e Planit të Veprimit ka përcaktuar ‘hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve për krijim lehtësirash për qarkullim të lirë të banorëve në zonat kufitare’. Në fushën e bashkëpunimit ndërkuftar, PK-ja ka të arritura 14 marrëveshje/protokolle të cilat vazhdojnë të zbatohen edhe sot. Nga ky numër, dy (2) prej tyre janë arritur me Shqipërinë me synimin që të krijojnë lehtësira për qarkullim të lirë të banorëve të zonave kufitare. Kurse, me Maqedoninë është përgatitur një draft marrëveshje, e cila pritët të jetësohet në të ardhmen. Bazuar në këtë, PK-ja ka patur gjithsej tre (3) iniciativa për krijim lehtësirash për qarkullim të lirë, por deri më tani ka arritur të realizojë dy (2) nga këto iniciativa.

3.3.9. Duke iu referuar detyrave të përcaktuara në pikën 3.3.3 të Planit të Veprimit lidhur me ‘zbatimin e aktiviteteve që dalin nga marrëveshjet e përbashkëta me shtetet fqinje’, PK-ja ka realizuar një numër aktivitete policore, të cilat prezantohen në tabelën e mëposhtme. Bazuar në informacionin e siguruar nga Departamenti i Kufirit, numri i patrullimeve me shtetet fqinje është në ngritje, gjë që e dëshmon edhe tabela me të dhëna statistikore sipas viteve. Në numrin e patrullimeve janë përfshirë të dhënat mbi patrullimet e përbashkëta dhe ato të sinkronizuara me njësitë e policisë kufitare të vendeve fqinje. Numri i patrullimeve ka shënuar rritje karshi takimeve ndërkuftare të cilat vërehet trend i rënies së numrit të tyre. Bazuar në marrëveshjet në fuqi, parashihet edhe bashkëpunimi ndërkombëtar në tri (3) nivele: lokal, rajonal dhe qendror. Tabela më poshtë jep një pasqyrë mbi numrin e takimeve ndërkuftare përgjatë periudhës kalendarike që mbulon realizimin Planit të Veprimit.

²⁷ Kjo i referohet Buletinit javor të inteligjencës

Tabela nr. 9. Paraqitja tabelore e aktiviteteve vjetore policore në zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta me shtetet fqinje (nëntor 2015)				
Aktivitetet ndërkufitare	Numri i aktiviteteve sipas viteve			
	2012	2013	2014	2015
Patrullime	218	263	391	308
Takime ndërkufitare	75	35	9	24

3.3.10. Për të pasqyruar aktivitetet policore të Departamentit të Kufirit në 'parandalimin e krimit ndër-kufitar', PK-ja ka ndërmarrë një varg aktivitete të lidhura me pikat 3.4.1 dhe 3.4.2 të Planit, të cilat janë prezantuar në tabelë. Duke marrë parasysh vetëm një numër të veprave më të shpeshta penale, ka një tendencë të ngritjes së numrit të rasteve të 'kalimeve ilegale të kufirit' dhe të 'kontrabandës me migrantë'. Kategoritë e rasteve: 'transporti ilegal i armëve' dhe 'posedimi i pa ligjshëm i armëve' janë në tendencë të uljes së numrit të përgjithshëm të rasteve, kurse kategoria e rasteve 'kontrabanda me narkotikë dhe 'falsifikimi i automjeteve' paraqiten në shifra të ndryshueshme gjatë viteve.

Tabela nr. 10. Paraqitja tabelore e aktiviteteve vjetore në parandalimin e krimit ndërkufitar (nëntor 2015)				
Lloji i krimit	Numri i aktiviteteve sipas viteve			
	2012	2013	2014	2015
Kalimi ilegal i kufirit	114	125	185	118
Kontrabandimi me migrantë	19	29	48	31
Kontrabandimi i narkotikeve	30	17	22	23
Transporti ilegal i armëve	51	19	12	9
Posedimi i paligjshëm i armeve	35	102	61	35
Falsifikimi i automjeteve	5	20	13	11

3.4. Identifikimi i problemeve në realizimin e Planit të Veprimit për Policimin në Bashkësi

3.4.1. Strategjia për Policimin në Bashkësi si një dokument strategjik për vënien në zbatim të një metodologjie të re të punës policore paraqet një sfidë për akterët e përfshirë në procesin e jetësimit të saj praktik. Zbatimi i kësaj Strategjie kërkon përkushtim dhe angazhim të të gjitha niveleve të organizimit policor, por që nuk përjashton edhe sfidimin e zbatimit të saj nga një numër faktorësh teknik dhe organizativ.

3.4.2. Duke vërejtur se ishte i konsiderueshëm numri i faktorëve që kanë sfiduar zbatimin praktik të Strategjisë, inspektorët kanë shfrytëzuar një formular unik të inspektimit për të lehtësuar identifikimin e faktorëve që kanë shkaktuar vështirësi në arritjen e objektivave strategjike. Ky formular u ka dhënë rastin zyrtarëve policorë të stacioneve policore që të paraqesin vështirësitë dhe sfidat në kryerjen e detyrave për të përmbushur me sukses detyrat e vëna me Plan. Vështirësitë apo pengesat kryesore që kanë atakuar përmbushjen me sukses të detyrave policore gjatë periudhës kalendarike 2012-2015 janë paraqitur përmes tabelës. Janë identifikuar shumë vështirësi/pengesa, por në këtë raport janë përmbledhur dhjetë (10) prej tyre si më kryesore, me të cilat janë ballafaquar stacionet policore.

Tabela nr. 11. Përmbledhje e faktorëve që kanë sfiduar realizimin e Planit të Veprimit në stacione policore									
Vështirësitë/pengesat	Gjilan	Prishtinë	Ferizaj	Mitrovicë Veriore	Mitrovicë Jugore	Pejë	Prizren	Gjakovë	Totali
Mungesa e pajisjeve teknike dhe logjistike në stacione policore	7	8	3	4	3	5	2	3	35
Mungesa e kapaciteteve të burimeve njerëzore	5	7	3	-	3	3	3	3	27
Aktivitetet e personelit në punë jo policore (asistimet, urdhëresat)	2	4	1	-	2	5	1	1	16
Mungesa e hapësirave për punë në stacione dhe bashkësi lokale	1	4	1	1	1	2	-	-	10
Transferet e shpeshta të policëve në sektorë në kuadër të stacioneve	-	5	-	-	-	1	-	1	7
Mungesa e besimit të komunitetit në ndërtimin e raporteve me policinë	-	1	2	1	-	1	-	1	6
Mungesa e njohurive për konceptin e policimit në bashkësi	2	-	-	2	1	1	-	-	6
Mungesa e trajnimeve adekuate për këtë lloj të policimit në bashkësi	-	1	1	-	1	1	-	1	5
Mosgatishmëria për pjesëmarrje në KLSP për shkak të mospagesës së angazhimit	1	1	1	-	-	-	-	-	3
Mosha e shtyrë e zyrtarëve policorë të caktuar për punë në sektor	1	-	-	-	1	-	-	-	2

3.4.3. Nëse iu referohemi të dhënave të tabelës të prezantuar nga vetë stacionet policore përmes formularit unik të inspektimit, del se:

- 35 nga gjithsej 40 stacione policore ballafaqohen me vështirësi të natyrës teknike dhe logjistike. Një numër i madh i tyre deklarohen se puna sektoriale shtron nevojën për numër më të madh automjesh policore por edhe pajisjesh teknike, si kompjuterë, printerë, makina fotokopjuese, aparate fotografike, etj.
- 27 nga gjithsej 40 stacione policore ballafaqohen me vështirësi të natyrës së burimeve njerëzore. Këtu duhet potencuar edhe brengat e disa stacioneve policore të kategorizuara në kategorinë 'C', për mungesën e disa pozitave që lehtësojnë ndërmarrjen e aktiviteteve që lidhen me policimin në bashkësi.
- 16 nga gjithsej 40 stacione policore paraqesin shqetësimet e tyre për angazhimin e kapaciteteve njerëzore në aktivitete jo policore, duke rënduar apo vështirësuar përkushtimin e tyre në punë sektoriale, si: asistimet në punën e inspektorateve, asistimet në angazhimet e KEDS-it, angazhimet rreth urdhëresave të gjykatave, etj.).
- dhjetë (10) nga gjithsej 40 stacione policore deklarojnë se ballafaqohen me mungesë hapësirash për punë, qoftë në stacione, apo për punë në terren, ku për këtë të fundit mund të ndikojë edhe në rënien e interesimit të komunitetit për bashkëpunim, pasi shpesh herë transmetimi i brengave të tyre kërkon qasje serioze.
- shtatë (7) nga gjithsej 40 stacione policore janë të shqetësuara për transferet e shpeshta që ndodhin në stacione, që mund të reflektojnë në ngecjen e bashkëpunimit me

komunitetin. Kjo bazohet në atë se zyrtarëve policorë të angazhuar në punë sektoriale u duhet kohë e madhe të ngritin bashkëpunimin me komunitetin, andaj ndryshimet në përbërjen e ekipeve sektoriale mund të krijojnë shkëputje në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të duhura me qytetarë.

- f) gjashtë (6) nga gjithsej 40 stacione policore janë deklaruar se nuk janë të kënaqur me bashkëpunimin me komunitetin për shkak të pamundësisë së krijimit të raporteve me të, që konsiderohet edhe çelës suksesi në jetësimin e Strategjisë. Këtu pjesa më e madhe stacioneve lidhet me territoret e banuara me qytetarë të pakicës serbe.
- g) gjashtë (6) nga gjithsej 40 stacione policore deklarohen se një nga vështirësitë serioze që sfidojnë jetësimin e Strategjisë është mungesa e njohurive nga radhët e qytetarëve mbi këtë koncept policimi, duke mos përjashtuar edhe Policinë. Në vendet ku ushtrojnë veprimtarinë këto stacione policore, ka munguar interesimi i qytetarëve për ndërtim marrëdhëniesh, në drejtim të zhvillimit të partneritetit reciprok.
- h) pesë (5) nga gjithsej 40 stacione policore konsiderojnë se nuk janë organizuar trajnime adekuate për të mundësuar jetësimin pa pengesë të Strategjisë. Sipas të dhënave të DT-së, në trajnime të policimit në bashkësi është përfshirë pjesa dërmuese e strukturës, duke mos nënkuptuar se të gjithë janë përfshirë në trajnim.
- i) tre (3) nga gjithsej 40 stacione policore ballafaqohen me mungesën e interesimit për përfshirje qytetare në përbërjen e KLSP-ve për shkak të mospagesës së angazhimeve të tyre. Kjo ndikon negativisht kur kemi parasysh se këto forume të sigurisë janë një mundësi e shprehjes së brengave të qytetarëve, që ndikon drejtpërdrejtë në ngritjen e shkallës së sigurisë brenda komunitetit.
- j) dy (2) nga gjithsej 40 stacione policore konsiderojnë se mosha e shtyrë e zyrtarëve policorë ndikon në rënien e efikasitetit të punës.

4. PËRFUNDIMET

4.1. Koordinatorin për Implementim e Monitorim të Planit të Veprimit të Strategjisë për Policimin në Bashkësi nxjerrë raporte të rregullta vjetore mbi nivelin e përmbushjes së detyrave strategjike, duke u bazuar në të dhënat e akterëve të përfshirë. Raportimet e tilla shpesh herë nuk kanë qenë përmbajtësore me të dhëna përmbledhëse, jo gjithëpërfshirëse dhe të përcjellura me mungesë analizash krahasuese.

4.2. Niveli lokal dhe rajonal nxjerrë raporte periodike dhe me kërkesë të nivelit qendror, lidhur me aktivitetet në përmbushjen e detyrave strategjike, por të dhënat e raportimit të këtyre niveleve (DRP-të dhe stacionet policore) në disa raste janë të pa përputhshme dhe të pa qëndrueshme me ato të prezantuara nga niveli qendror.

4.3. Me gjithë faktin se shumë akterë janë përfshirë në përmbushjen e detyrave të vëna me Plan veprimi, IPK-ja nuk ka arritur të sigurojë nga PK-ja se cilat janë parametrat e pranueshëm performues në bazë të të cilëve ajo do të mund të krahasonte performancën e përgjithshme, sidomos ato raste që lidhen me aktivitete të konsideruara si dinamike.

4.4. Është vërejtur se me gjithë që është punuar kënaqshëm në arritjen e synimeve strategjike, vërehen dobësi në respektimin e afateve kohore siç parashihen në Planin e Veprimit, duke shtruar kërkesën që në të ardhmen kësaj pike t'i kushtohet kujdesi i duhur.

4.5. Edhe pse Koordinatorin për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Policimin në Bashkësi dhe Grupi Punues për Zbatim e Monitorim realizojnë takime pune me akterë të përfshirë në proces, IPK-ja ka vërejtur se në disa pika të Planit të veprimit këta të fundit nuk kanë konceptuar qartë të gjitha informatat që duhet prezantuar në raportimet e tyre. Ka edhe raste kur nga niveli lokal nuk janë kuptuar qartë termat e referencës si: 'partnerë të identifikuar', 'indikatore', 'prezantim i mundësive', 'bazat e të dhënave mbi KLSP-të', etj.

4.6. Raportimet e të gjitha niveleve të organizimit policor dëshmojnë për një ecje para në ndërtimin dhe thellimin e bashkëpunimit me komunitetin, por IPK-ja ka vërejtur se në kuadër të disa sektorëve policorë që kanë zonë përgjegjësie territoriale dhe vendbanime të caktuara, ka ngecur ky proces dhe kjo vërehet më dukshëm tek stacionet policore që ushtrojnë veprimtari policore në vendbanimet me popullsi pakicë.

4.7. Jetësimi i realizimit të Strategjisë dhe përgjithësisht konceptit në tërësi të policimit në bashkësi i ka munguar përgatitje më e duhur e akterëve të përfshirë me kushte të nevojshme qofshin të natyrës teknike/logjistike por edhe të asaj organizative. Stacionet ballafaqohen me mungesë të automjeteve, pajisjeve teknike dhe hapësirave për punë.

4.8. PK-ja ka ndërmarrë disa hapa në drejtim të krijimit dhe funksionalizimit të Muzeut policor. IPK-ja ka vlerësuar aktivitetet e deritanishme të akterëve policorë të caktuar në përmbushjen e kësaj detyre, por nuk e konsideron si proces të përmbyllur.

4.9. Deri në këtë fazë të jetësimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, nuk është nxjerrë Doracak i policimit në bashkësi. IPK-ja ka vërejtur se DPSÇL-ja dhe partnerët nuk kanë lëvizur në këtë drejtim edhe pse mbetet ende kohë për përmbushjen e një detyre të vënë.

4.10. Me gjithë ndarjen e burimeve njerëzore për punë sektoriale si element i realizimit të konceptit të policimit në bashkësi, IPK-ja vlerëson se Policia humb shumë kapacitete aktive

njerëzore në aktivitete të cilësuar jo policore. Këto aktivitete jo policore ndikojnë në rënien e efikasitetit policor në angazhimet sektoriale.

4.11.IPK-ja ka siguruar evidenca nga akterët e përfshirë në policimin në bashkësi, por në disa raste vlerëson se për shumë aktivitete nuk mbahen shënime, që në fakt prezantimi i tyre do të ofronte një pasqyrë reale të angazhimeve të tyre. Stacionet policore gjatë raportimit të aktiviteteve që lidhen me përmbushjen e detyrave që dalin nga Plani veprues, në disa raste nuk dëshmojnë evidenca mbi të dhënat e pasqyruara.

5. REKOMANDIMET KRYESORE

Bazuar në të gjeturat e inspektimit dhe përfundimet e arritura, IPK-ja nxjerrë për PK-në këto rekomandime kryesore:

- 1. IPK-ja i rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit të dalë nga Strategjia për Policimin në Bashkësi dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, që të sigurohen se raportimet e tyre në të ardhmen të jenë më përmbledhëse, më të qarta dhe të përmbajnë analiza me të dhëna të krahasueshme.*
- 2. IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit, koordinatorëve rajonalë të policimit në bashkësi, udhëheqësve të stacioneve policore dhe akterëve tjerë të përfshirë në proces, që gjatë raportimeve periodike mbi aktivitetet në përmbushjen e detyrave, të ofrojnë informata të qëndrueshme dhe të bazuara në veprime praktike.*
- 3. IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit, Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, udhëheqësve të DIA-s, udhëheqësve të DRP-ve dhe stacioneve policore, që të kryejnë analiza mbi pikat që konsiderohen të ngecshme dhe që ndikojnë direkt në performancën policore në raport me komunitetin.*
- 4. IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, që në të ardhmen t'iu qartësojnë akterëve të përfshirë në përmbushjen e detyrave të dhëna, t'iu kushtojnë kujdes të duhur respektimit të afateve të përcaktuara kohore.*
- 5. IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, që në takimet apo vizitat e realizuara me akterë që kryejnë raportime periodike, t'iu bëjnë të qartë atyre se cilat informata janë të nevojshme të prezantohen në raportet e tyre informuese mbi nivelin e përmbushjes së detyrave të Planit.*
- 6. IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit, Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, udhëheqësve të DRP-ve dhe të stacioneve policore, që të kryejnë analizat e duhura për të konstatuar hezitimin e disa vendbanimeve apo sektorëve, për të kontribuar në zhvillimin dhe avancimin e partneritetit reciprok.*
- 7. IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet e Financa, Drejtorit të Drejtorisë së Logjistikës dhe Drejtorit të Drejtorisë së Personelit, që të marrin seriozisht shqetësimet e niveleve të organizimit policor, mbi vështirësitë teknike, logjistike dhe organizative të paraqitura gjatë jetësimit praktik të konceptit të policimit në bashkësi.*
- 8. IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, që deri në përfundim të periudhës kalendarike strategjike, të shtyjnë para projektin e Muzeut policor.*

9. *IPK-ja i rekomandon Drejtorit të DPSÇL-së që në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, të angazhohet në nxjerrjen dhe shpërndarjen e Doracakut për policimin në bashkësi.*
10. *IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të shqyrtojë situatat kur PK-ja hendikepohet me mungesë të personelit në punë sektoriale për shkak të angazhimeve të tyre në aktivitete jo policore.*
11. *IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të stacioneve policore që përfshihen në raportimet e rregullta periodike mbi aktivitetet e ndërmarra, që për çdo veprim praktik të sigurojnë/mbajnë evidenca apo burimin e informatës.*

6. PLANI I VEPRIMIT PER PERMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE

Nr	Rekomandimi	Prioriteti	Komentet	Plani i veprimit
1.	IPK-ja i rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit të dalë nga Strategjia për Policimin në Bashkësi dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, që të sigurohen se raportimet e tyre në të ardhmen të jenë më përmbledhëse, më të qarta dhe të përmbajnë analiza dhe të dhëna të krahasueshme.	- I lartë	Deri ne këtë faze është vepru sipas rekomandimit te juaj. Do te jete prioritet i përhershëm dhe ne raportet e ardhshme (gjatëgjithë vitit 2016) do te kemi ne konsideratë rekomandimin dhe do te kujdesemi qe te implementohet nëtersi.	Gjatë tërë vitit 2016
2.	IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit, koordinatorëve rajonalë të policimit në bashkësi, udhëheqësve të stacioneve policore dhe akterëve tjerë të përfshirë në proces, që gjatë raportimeve periodike mbi aktivitetet në përmbushjen e detyrave, të ofrojnë informata të qëndrueshme dhe të bazuara në veprime praktike.	I lartë Do jetë prioritet qe raportet te jenë të mbështetura në punën dhe angazhimin konkret.	Edhe deri me tani raportet e Koordinatorit janë te bazuara ne raporte te aktiviteve policore ngangatereni. Do te vazhdohet me raportime te specifikuar sipas kërkesave te dala nga plani i veprimitme qellim te matjes se progresit te implementimit	Gjatë tërë vitit 2016
3.	IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit, Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, udhëheqësve të DIA-s, udhëheqësve të DRP-ve dhe stacioneve policore, që të kryejnë analiza mbi pikat që konsiderohen të neqeshme dhe që ndikojnë direkt në performancën policore në raport me komunitetin.	I lartë	Edhe gjer me tani përformanca policore ne raport me komunitetin ka qenë top prioritet dhe i tillë do tëmbetet. Është realizuar me sukses te plote pilot projekti ne DRP Ferizaj ne lidhje me ngritjen dhe kualitetin e informatave inteligjente ku është dhjetëfishu numri dhe kualiteti i informatave, i njëjti projekt është duke u implementu ne te gjitha DRP te	Është duke u implementu dhe do te vazhdoj edhe ne ardhmen.
4.	IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, që në të ardhmen t'iu qartësojnë akterëve të përfshirë në përmbushjen e detyrave të dhëna, t'iu kushtojnë kujdes të duhur respektimit të afateve të përcaktuara kohore.	I lartë	Edhe deri me tani afatet janë respektuar ne përmbushjen e detyrave nga plani i veprimit. Me tejkalimin e pengesave eventuale jemi përballur dhe do te përballemi edhe ne te ardhmenshpresoj me sukses.	Gjatë gjithë kohës implementi mit te Planit te veprimit
5.	IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, që në takimet apo vizitat e realizuara me akterë që kryejnë raportime periodike, t'iu bëjnë të qartë atyre se cilat informata janë të nevojshme të prezantohen në raportet e tyre informuese mbi nivelin e	I lartë	Rekomandimi do te përcjellët ne bazëdhe do te kërkohet implementimi i tij. Duke kërkuar statistika krahasimorë dhe raporte te bazuara ne analiza	Gjatë gjithë kohës se implementi mit te planit veprimit

	<i>përmbushjes së detyrave të Planit.</i>			
6.	<i>IPK-ja u rekomandon Koordinatorit për Implementimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit, Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, udhëheqësve të DRP-ve dhe të stacioneve policore, që të kryejnë analizat e duhura për të konstatuar hezitimin e disa vendbanimeve apo sektorëve, për të kontribuar në zhvillimin dhe avancimin e partneritetit reciprok.</i>	I lartë	<i>Aty ku konstatojmë hezitim në zhvillimin e partneritetit do të ndermirren veprime adekuatenga menaxhmenti i njësisë.</i>	Gjatë gjithë kohës
7.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorit të Drejtorisë së Logjistikës dhe Drejtorit të Drejtorisë së Personelit, që të marrin seriozisht shqetësimet e niveleve të organizimit policor, mbi vështirësitë teknike, logjistike dhe organizative të paraqitura gjatë jetësimit praktik të konceptit të policimit në bashkësi.</i>	I lartë	<i>Menaxhmenti i lartë i PK-së është në dijeni për vështirësitë e cekura dhe konformmundësive buxhetore ndërmerr veprimet e duhura në tejkalimin e vështirësive të cekura. Në muajin nëntor dhe dhjetor të 2015 Policia e Kosovës është pajisur me 45 vetura të reja policore dhe 250 kompjuter dhe në periudhënaftatgjatë do të pajiset gjithsejtë me 210 automjete policore dhe gjithë kjo pajisje është e dedikuar për St. Pol. dhe DRP-te</i>	Gjatë gjithë kohës
8.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Grupit Punues për Zbatim dhe Monitorim, që deri në përfundim të periudhës kalendarike strategjike, të shtyjnë para projektin e Muzeut policor.</i>	<i>Imesëm</i>	<i>Do të shikohen mundësitë objektive që projekti të vazhdojë se implementuari.</i>	<i>Gjatë vitit 2016</i>
9.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të DPSÇL-së që në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, të angazhohet në nxjerrjen dhe shpërndarjen e Doracakut për policimin në bashkësi.</i>	<i>Është Realizuar</i>	<i>Është nxjerr Doracaku dhe shpërndarë në njësi organizative. Në të është Strategjia dhe Plani i Veprimit i Policimit në Bashkësi 2012-2016</i>	<i>PK-ja konsideron që nuk është i nevojshëm ndonjë Doracak tjetër në këtë etapë të implementimit.</i>
10.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të shqyrtojë situatat kur PK-ja hendikepohet me mungesë të personelit në punë sektoriale për shkak të angazhimeve të tyre në aktivitete jo policore.</i>	I lartë	<i>Menaxhmenti i PK-së angazhon stafin policorë sipas prioriteteve dhe vlerësimeve në ofrimin e sigurisë së qytetarëve.</i>	<i>Gjatë gjithë kohës</i>
11.	<i>IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të stacioneve policore që përfshihen në raportimet e rregullta periodike mbi aktivitetet e ndërmarra, që për çdo veprim praktik të sigurojnë/ mbajnë evidenca apo burimin e informatës.</i>	I lartë	<i>Stacionet policore do të implementojnë rekomandimin në mënyrë strikte</i>	<i>Gjatë gjithë kohës</i>